REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br 15/23
Nr. i fq. / Br. st -1-
Data: / Datum 19. 01. 2023
VUSHTRRI - VUČITRN

**REPUBLIKA E KOSOVËS** **KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI**

---

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28.1 të Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 6.3 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës dhe Organeve të Tij, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

**Ju fton**

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **31 janar 2023 (e martë) me fillim në ora 10:00.** Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtrri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

**R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 29 dhjetor 2022;
2. Shqyrtimi i Raportit për të hyrat dhe shpenzimet për periudhën janar – dhjetor 2022;
3. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të veprimtarive afariste-bizneseve në Komunën e Vushtrrisë;
4. Të ndryshme.

**Melihate Basholli-Latifi**

**Kryesuese e Kuvendit të Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br 14/23
Nr. i fq. / Br. st -1-
Data: / Datum 19.01.2023

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA VUSHTRRI**
**OPŠTINA VUČITRN**

| | |
|---|---|
| **DATË:** | **19.01.2023** |
| **PËR/ZA/TO:** | **Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë** |
| **NGA/OD/FROM:** | **Melihate Basholli-Latifi**<br>**Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë** |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | **Njoftim** |

Të nderuar anëtarë të kuvendit të komunës,

Ju njoftojmë se mbledhja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë e planifikuar të mbahet më datë 26.1.2023, e njëjta do të mbahet më datë 31.1.2023 (e martë) nga ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë. Shtyrja e mbledhjes është bërë pas kërkesës të kryetarit të komunës, i cili ndodhet në udhëtim zyrtar, si dhe në konsultim me kryesuesin e kuvendit.

Bazuar në Plani e Planin e Punës të Kuvendit ku është paraparë shqyrtimi i raportit vjetor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, kryetari i komunës ka obligim ligjor të raportoj para kuvendit të komunës (referuar nenit 58 pika “j” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale).

Lidhur me kërkesën për futjen në rend të ditës, të kërkesës për shkarkimin e kryesueses të kuvendit, ju njoftojmë se ky propozim do të futet në rendin e ditës konform Statutit të Komunës së Vushtrrisë.

**Me respekt!**

## Bastri Duraku

**From:** Melihate Basholli Latifi
**Sent:** Thursday, January 19, 2023 12:07 PM
**To:** Bastri Duraku
**Subject:** FW: Kerkese per shtyerje te mbledhjes

---

**From:** Ferit Idrizi
**Sent:** Monday, January 16, 2023 4:24 PM
**To:** Melihate Basholli Latifi <melihate.basholli.latifi@rks-gov.net>
**Cc:** Shpetim Zhegrova <shpetim.zhegrova@rks-gov.net>; Bujar Shatrolli <bujar.shatrolli@rks-gov.net>; Albiona Isa <albiona.isa@rks-gov.net>; Bastri Duraku <bastri.duraku@rks-gov.net>; Bujar Klinaku <bujar.klinaku@rks-gov.net>
**Subject:** Kerkese per shtyerje te mbledhjes

E nderuar Kryesuese e Kuvendit znj.Basholli,

Kërkoj nga ana juaj që mbledhja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, e planifikuar të mbahet me 26 janar 2023, të shtyhet për datën 31 janar 2023.
Kjo për faktin se prej datës 20 deri me datën 27 janar 2023, jam në udhëtim zyrtar në Gjermani, së bashku me nënkryetarin e komunës z.Zhegrova.
Duke e parë rendin e ditës, më saktësisht pikën "Shqyrtimi i Raportit për të hyrat dhe shpenzimet për periudhën janar-dhjetor 2022", kërkoj që kjo seancë të shtyhet për datën 31 janar 2023, pasi në pikën e lartcekur të rendit të ditës është e domosdoshme të prezentoj kryetari i komunës raportin për të hyrat dhe shpenzimet për periudhën janar-dhjetor 2022.
Për këtë i referohem nenit 58, shkronjës "j" të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, ku thuhet kryetari "raporton para kuvendit të komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës"

Me respekt,

---

**Ferit Idrizi**
Kryetar i Komunës së Vushtrrisë
Komuna Vushtrri
Tel: +383 38 200 42 402
Adresa: Sheshi Ahmet Krasniqi nr 10, 42000, Vushtrri

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br 10/23
Nr. i fq. / Br. st -1-
Data: / Datum 17.01.2023

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA VUSHTRRI**
**OPŠTINA VUČITRN**

| | |
|---|---|
| **PËR/ZA/TO:** | **Kuvendin e komunës** |
| **NGA/OD/FROM:** | **Melihate Basholli Latifi**<br><br>**Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë** |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | **Sekretarisë së kuvendit** |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 16.1.2023** |

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafit 4 të Statutit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më **16 janar 2023** ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Shqyrtimi i Raportit për të hyrat dhe shpenzimet për periudhën janar – dhjetor 2022.
   *Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
   *Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

2. Shqyrtimi i Raportit analitik nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për punën dhe të hyrat buxhetore për vitin 2022.
   *Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
   *Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

*Me respekt!*

**REPUBLIKA E KOSOVËS** **KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI**

# P R O C E S V E R B A L
# NGA MBLEDHJA E –X- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 29 DHJETOR 2022

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën* ***10:20.***
Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:
Adnan Lahu, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Bujar Pllana, Blerina Shala, Edona Gashi, Fakete Dushi, Faton Hyseni, Gentiana Rama, Refik Maloku, Galip Avdiu, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kastrati, , Mensur Kasumi, Nurie Halili, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Shkelzen Xhaferi, Sylejman Meholli, Spasoje Stefanoviq, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

**Munguan:** Nasuf Aliu, Fatmire Cecelia, Gresa Muli dhe Mentor Hasani.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallën e kuvendit, ka kuorum të mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.
Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës z.Ferit Idrizi, nënkryetari i komunës z. Shpëtim Zhegrova, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

**Melihate Basholli-Latifi-kryesuese e kuvendit-**pasi i përshëndeti të pranishmit prezantoj para kuvendit iniciativën e Qendrës Gjenocidi në Kosovë "Plagë e Hapur" e drejtuar nga veprimtari i çështjes kombëtare z.Bardhyl Mahmuti i cili i është drejtuar institucioneve shtetërore dhe forcave politike në Kosovë që "Lulëkuqja me katër Petale" të bëhet simbol unik i përkujtimit të gjenocidit në Kosovë. Lulëkuqja e propozuar për të përfaqësuar gjenocidin këtë plagë të hapur, është simbol unik, ashtu siç është unike edhe sakrifica sublime e kombit tonë. Këtë nismë ajo e ka mbështetur publikisht përmes rrjeteve sociale dhe jo vetëm dhe është përpjekur që e njëjta të ketë sa më shumë përkrahës. Kjo qendër i është drejtuar me kërkesë e që të njëjtën e ka pranuar edhe kryetari i komunës, dhe pasi analizuan arsyetimin që e shoqëron kërkesën si dhe pas konsultimeve me grupin kuvendar të PDK-së dhe pasi që jemi në vigjilje të 15 janarit si datë që përkujton gjenocidin në Kosovë, propozoi në emër të grupit kuvendar të PDK-së të futet si pikë shtesë deklarata që Lulëkuqja me Katër Petale të bëhet simbol unik përkujtimor i gjenocidit në Kosovë.
**Refik Maloku, anëtar i kuvendit-**tha se siç edhe jeni në dijeni që mbledhjen e mbajtur para dy muajsh grupet kuvendare të LVV-së dhe të LDK-së e kishin lëshuar mbledhjen në mënyrë simbolike si reagim ndaj zhvillimeve që kishin ndodhur në mbledhjen e muajit tetor, ku është shkelur e drejta elementare e njeriut e drejta për të votuar. Nga ato zhvillime kaluan dy muaj dhe

asnjë veprim, asnjë komunikatë dhe asnjë vendim në lidhje me shkeljet që janë bërë në këtë kuvend. Ata kanë qenë prezent kur kanë ndodhur së paku tri shkelje në atë mbledhje e para është votuar në emër të dikujt tjetër, pastaj janë nxitur nga nënkryetari i komunës veprimet e tilla, dhe e treta kryesuesja e kuvendit e ka monitoruar këtë çështje dhe nuk ka pasur asnjë reagim prej saj dhe njëfarë forme kjo çështje ka ndodhur me bekimin e saj. Andaj të gjithë e dimë se këto veprim janë të dënueshme me ligj dhe për këtë një grup kuvendar ka bërë kallëzim penal për këto veprime. Por kuvendi i ka disa mundësi që duhet të ushtroj, kuvendi nuk mundet të veproj ndajë nënkryetari i cili është i caktuar nga kryetari i komunës, nuk mund të veprohet ndaj asamblistëve që janë të zgjedhur, por kuvendi ka të drejtë të veproj ndaj kryesueses së kuvendit e cila nuk ka ndërmarr asnjë masë dhe nuk ka bërë asnjë prononcim publik deri tani për veprimet e ndërmarra. Kryesuesi i kuvendit është një organ i cili e përfaqëson kuvendin, dhe nëse kryesuesja e kuvendit nuk mund ta përfaqësojë denjësisht kuvendi, atëherë ajo nuk mund ta ushtoj më tutje këtë pozitë. Kësisoj duke marrë për bazë këto të gjetura dhe zhvillime ai propozoi që të futet në rend të ditës propozimi i votëbesimit apo shkarkimi i kryesueses së kuvendit.
**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-**lidhur me diskutimin dhe propozimin e parafolësit të tij, vlerësoi se ai asnjëherë më parë nuk kishte kërkuar shkarkimin e kryesueses së kuvendit, por duke marr për bazë shkeljet dhe lëshimet që kanë ndodhur muaj më parë, dhe duke marr parasysh mos mundësinë e menaxhimit të duhur të seancave të kuvendit, por edhe punët tjera me shkresat zyrtare dërguar institucioneve tjera. Pastaj duke marr për bazë që deputetja Melihate Basholli, ka dhënë një kontribut të çmuar në disa mandatet konsideron se ajo akoma mundet të japë kontribut si deputet por jo në pozitën e kryesuese së kuvendit. Më tej shtoj se vota e tij e ka vendosur në pozitën e kryesueses së kuvendit, dhe kësisoj ai vlerëson se deputetja Basholli-Latifi më nuk mund të qëndroj në pozitën e kryesuese së kuvendit, andaj deklaroi se nëse futet në rend të ditës vota e tij do të jetë *<për>* shkarkimin e saj nga pozita e kryesueses së kuvendit.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**tha se shoqëria jonë funksionon mbi bazat e demokracisë, andaj nuk ka asgjë të keq nëse futet në rendin e ditës propozimi për votëbesimin e kryesuese së kuvendit. Janë anëtarët e kuvendit ata që i japin kahje me votë çështjes së pozitës së kryesuese së kuvendit, andaj një propozim të tillë e përkrahin si grup kuvendar.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**në adresimin e tij para anëtarëve të kuvendit, falënderoj gjithë qytetarët e Vushtrrisë, anëtarët e kuvendit dhe gjithë zyrtaret tjerë komunal, në rastin e fund vitit, duke shtuar se ishte një vit vërtetë shumë sfidues për shkak të krizës globale ekonomike që e preku edhe vendin tonë Republikën e Kosovës dhe në këtë rast edhe komunën tonë. Në veçanti ai falënderoj anëtaret e kuvendit për siç kontributin e tyre për aprovimin e statutit të komunës, miratimin e buxhetit të komunës dhe një mori të akteve tjera të rëndësishme për funksionimin dhe zhvillimin e komunës tonë. Lidhur me propozimin për votëbesimin e kryesueses së kuvendit, ceku se askush nuk është i paprekshëm në pozitat publike, por megjithatë kërkoj që pasi jemi në seancën e fundit të këtij viti mos të futet ky propozim që jepet shije e keqe këtij fund viti. Kërkoj mirëkuptimin e gjithë kuvendarëve që ky propozim të shtyhet për ndonjërën nga mbledhje e ardhshme të kuvendit duke u respektuar edhe procedurat ligjore. Në fund edhe njëherë apeloj për bashkëpunim dhe kritikë të shëndosh, dhe po ashtu kërkoj në fund të jeni në një drekë të përbashkët pas përfundimit të mbledhjes se kuvendit duke uruar njëri tjetrin për fund vit.
**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-**tha se pikërisht diskutimi i kryetarit të komunës është shkas për inicimin e procedurës për shkarkimin e kryesuese së kuvendit, pasi që kryesuesja nuk është duke e kryer punën e saj mirë në menaxhimin e seancave të kuvendit, kjo edhe për faktin se anëtarët e kuvendit debatojnë për çështje ekskluzive të kuvendit siç është shkarkimi i kryesueses së saj dhe del në foltore kryetari i komunës e bënë thirrej për mos votimin e këtij mocioni, dhe kjo nuk është

e drejt e kryetarit të komunës sepse kuvendi është i ndarë nga ekzekutivi i komunës. Tutje shtoi se nuk i takon kryetari të komunës të ndërhyj në punët e kuvendit sepse kjo paraqet shkelje flagrante dhe nuk i shërben askujt. Pastaj shtoi se keqpërdorimi i kryesuese së kuvendit nga ekzekutivi po bëhet me bekimin e saj sepse ajo vet e ka lejuar një gjë të tillë në vazhdimësi dhe i'u ka krijuar komoditet për një trajtimi të tillë të saj. Një qasje e tillë nuk i shërben askujt dhe askujt nuk i bënë nder veçanërisht kryesueses së kuvendit. Në fund kërkoj që të hedhet në votim propozimi për votëbesimin e kryesueses së kuvendit dhe nëse një propozim i tillë i merr votat e nevojshme le te procedohet me tutje.
**Refik Maloku, anëtar i kuvendit-**kërkoj nga kryetari i komunës që raportet ndërnjerëzore dhe ato politike ti ndaj dhe asnjëherë të mos përzihen. Pastaj shtoi se miq edhe shok ka në të gjitha subjektet politike, por këtu duhet të ndahen këto raporte sepse bëhet fjalë për çështje zyrtare, kërkoj nga kryesuesja e kuvendit që mos të lejoj që kryetari dhe nënkryetari i komunës të interferojë në punën e kryesueses së kuvendit. Bile propozoi që kryetari dhe nënkryetari i komunës ta lëshojnë mbledhjen deri sa të vendoset për propozimin e votëbesimit.
**Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit-**në lidhje me propozimin e anëtarit të kuvendit z.Refik Maloku për votëbesimin e kryesueses së kuvendit, deklaroi se duhet të jemi të qartë dhe ti kujtojmë disa sekuenca edhe nga vitet e kaluara por edhe gjatë këtij vitit, dhe beson se kishte me qenë mirë që të përgëzohet kryesuesja e kuvendit për punën e saj që ka bërë ku gati të gjitha pikat e rendit të ditës kanë kaluar në formë unanime, respekti ka qenë maksimal ndaj opozitës, askujt nuk i është mohuar fjala të gjithë kanë pasur kohen dhe momentumin e kërkuar. Ky kuvend është udhëhequr në mënyrën më të mirë të mundshme nga kryesuesja e kuvendit znj. Basholli-Latifi dhe konsideron se nuk është momenti i duhur që të shfrytëzohet ndoshta raporti i fuqisë së numrave që mendohet se i kanë për ta shkarkuar kryesueses e kuvendit. Lidhur me pretendimet për zhvillimet më herët në kuvend opozita iu është drejtuar instancave gjyqësore, dhe është mirë që kjo çështje ti lihet organeve gjyqësore sepse PDK beson në gjyqësorin e Kosovës për kundër të tjerëve. Tutje shtoi se ai e njeh integritetin e znj. Basholli-Latifi, dhe beson se nëse ndonjë vendim i saj bie ndesh me kornizën ligjore të Republikës së Kosovës e që vërtetohet nga instancat gjyqësore, kryesuesja e kuvendit do ti marrë vet përgjegjësit e saj pa pasur fare nevojë të shkohet në votëbesim. Mandej rikujtoj se edhe anëtari i LVV-së në mandatin e kaluar ka qenë kryesues i kuvendit dhe atëherë PDK i ka pasur numrat për ta shkarkuar atë por nuk e ka marr një veprim të tillë edhe pse e kishte atë mundësi. Në fund tha se beson se ky nuk është momenti më i duhur për atë që po kërkohet dhe vlerësoi se kjo nuk i shërben askujt e as pozitës sepse edhe nëse e shkarkon kryesuesen e kuvendi, politikisht asgjë nuk përfiton as opozita dhe kësisoj duhet thënë se PDK është e vendosur që mandatin ta qoj deri në fund, andaj në emër të PDK-së i falënderoj të gjithë për bashkëpunimin, andaj kërkoj nga z.Refik Maloku që ta tërheq propozimin.
**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-**në emër të grupit kuvendar të AAK-së, deklaroi se nuk e përkrahin propozimin për votimin e mocionit të votëbesimit ndaj kryesueses së kuvendit dhe njëherazi falënderoj kryesuesen e kuvendit për punën e mirë që ajo ka bërë. Ajo ka udhëhequr suksesshëm kuvendi dhe pikat e rendit të ditës kanë kaluar pa problem duke spikatur se është aprovuar statutin dhe buxhetin e komunës. Ai e falënderoj kryesuesin e kuvendit dhe i uroj suksese në punën e saj për këto vite mandat sa i kanë mbetur.
**Refik Maloku, anëtar i kuvendit-**kërkoj që të del në votim propozimi për votimin e mocionit të votëbesimit ndaj kryesueses së kuvendit, duke deklaruar se nuk tërhiqet nga propozimi i tij.
**Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-**tha se është dashur që gjithë anëtarët e kuvendit ta dinë dhe të jenë në njohuri për normat që janë të përcaktuara me statutin e komunës që rrjedhin nga neni 26 i tij e që i referohen shkarkimit të kryesuesit/es në vijim ajo lexoj para anëtarëve të

kuvendit dispozitat e nenit 26 të statutit të komunës: 1.Krysuesi/ja i/e Kuvendit mund të shkarkohet me votat e më tepër se 50% plus një votë, të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit.
2.Kërkesën për shkarkim të Kryesuesit/es të Kuvendit të komunës mund ta bëjë me shkrim dhe nënshkrimet e së paku një të tretat (1/3) e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit të komunës, së paku dhjetë (10) ditë para mbajtjes të mbledhjes së rregullt.
3.Lidhur me shqyrtimin e kërkesës nga paragrafi 2 i këtij neni, vendos Kuvendi i komunës me shumicën e votave të anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit.
4.Votimi për shkarkimin e Kryesuesit/es bëhet me votim të fshehtë.
5.Të gjitha procedurat tjera për shkarkim rregullohen me Rregulloren e punës të Kuvendit.
Tutje deklaroi se vet si njerëz jemi të përkohshëm në këtë jetë, e po ashtu edhe në pozitat tona dhe në punët tona jemi të përkohshëm. Është përpjekur dhe do të përpiqet që të punoj në bazë të legjislacionit në fuqi, andaj kërkoj edhe nga anëtarët e kuvendit ti respektojnë dispozitat në fuqi, duke e pruar me kohë këtë propozim në kuvend dhe pa problem ai do ta merr epilogun e duhur.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**lidhur me çështjen që u ngrit përkujtoj se është në kompetencën e anëtarëve të kuvendit që të propozoj para kuvendit propozime që të futen në rend të ditës, dhe kryesuesja e kuvendit është e obliguar që ti hedh në votim, për ti inkorporuar në rendin e ditës. Nuk mund të propozosh diçka e të futet në rendit të ditës dhe tjetrit të i’a mohosh këtë të drejtë. Propozimet e bëra në kuvend janë procedura demokratike, dhe pavarësisht kush i bënë ato nuk do të thotë se epilogu është se ato aprovohen. Deri tani u trumbetua se gjatë viti janë miratuar çështje më interes të përgjithshëm e që janë përkrahur edhe nga opozita, ndërsa tani kur opozita propozon diçka përnjëherë opozita bëhet e “keq” kjo nuk funksionon kështu, propozimet janë mjete demokratike dhe nuk mund të paragjykohet epilogu përfundimtar i kësaj çështje. Duhet të kemi përqendrim për vendimin që po provoni ta merrni sepse më herët u kërkua që kjo çështje të shtyhet për mbledhjen e radhës dhe tani na thuhet se nuk kemi drejt ligjore të votojmë për këtë çështje.
**Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-**tha se bazuar në statutin e komunës nuk kemi të drejtë që të votojmë sot për mocion mosbesimi ndaj kryesueses së kuvendit, por kjo nuk do të thotë se mohon vullnetin e kuvendit, për sqarime më profesionale kërkoj mendimin e zyrës ligjore të komunës.
**Ismet Gashi, udhëheqës i zyrës ligjore të Komunës-**deklaroi se nuk ka çfarë ti shtoj nenit 26 të statutit të komunës që e citoj kryesuesja e kuvendit sepse është normë obliguese, por është ky statut i komunës i aprovuar nga kuvend që nganjëherë po tentohet të shmanget dhe kjo nuk është e drejt. Më tej shtoi se Ligji për Vetëqeverisje Lokale, nuk e rregullon çështjen e shkarkimit të kryesueses së kuvendit, ne e kemi rregulluar këtë çështje me statut dhe përderisa Është kështu duhet ti përmbahemi.
**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-**duke ju referuar dispozitave të statutit të komunës deklaroi se çështja e votëbesimit të kryesuese së kuvendit nuk mund të procedohet në rend dite sot, sepse është kundër-statutare, sepse për ta proceduar këtë çështje nevojite me sa vijon: *Kërkesën për shkarkim të Kryesuesit/es të Kuvendit të komunës mund ta bëjë me shkrim dhe nënshkrimet e së paku një të tretat (1/3) e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit të komunës, së paku dhjetë (10) ditë para mbajtjes të mbledhjes së rregullt.*
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**tha se në mbledhjen e kaluar jashtë dispozitave të statutit të komunës u procedua dhe u votua një çështje që lidhet me ngritjen e lapidarit në fshatin Pasomë për “Adem Vocen” , bile kishte diskutime që ranë në kundërshtim me zyrën ligjore, dhe po i njëjti kuvend e votoj atë pikë në kundërshtim të plotë me statutin e komunës, andaj nëse është gabim ajo

se çfarë sot po propozojnë anëtarët e kuvendit, ekziston një shkallë e dytë që quhet MAPL, e cila i kontrollon komunat e Kosovës, dhe nëse ky vendim është i kundërligjshëm atëherë ministria do rikthejë këtë vendim. Prandaj kërkoj që të përfillet vullneti i kuvendit duke votuar propozimin, në të kundërtën le te deklarohet qeveria se kur duhet ta respektojmë ne si kuvend statutin dhe atëherë jemi në rregull vetëm letë thuhet në këtë formë.
**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-**tha se ne morëm mendimin e zyrës ligjore, por shtoj se neni 26 i statutit përcakton vetëm mënyrën për iniciativat e grupeve të caktuar brenda kuvendit, ndërsa e drejtë ekskluzive e çdo anëtari të kuvendit është me propozuar mocionin e mosbesimit të kryesueses në çdo seancë pa pasur nevojë të mblidhen nënshkrimet, dhe për tu realizuar kjo duhet që me shumicë të thjeshtë të votave të konfirmohet se shkon tutje propozimi apo nuk procedohet më tej. Në rastin konkret kemi një propozim të bazuar në ligj i cili nuk është në kundërshtim me statutin e komunës dhe i njëjti duhet të procedohet për votim për inkorporim në rendin e ditës. Andaj është demokratike që të votohet ky propozim pa u frikësuar nga asgjë sepse zgjedhja dhe shkarkimi bëhet me vota të anëtarëve të kuvendit.
**Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-**tha se nuk ka frikë prej askujt, dhe shtoi se ajo mori konfirmimin e zyrës ligjore, për ligjshmërinë e propozimit, andaj ajo do ta respektoj statutin dhe kërkoj nga secili anëtar i kuvendit që ta bëjë një gjë të tillë.

**Pas debateve lidhur me pikat e rendit të ditës të procedura në pikën në të ndryshme kuvendi pas votimit me 12 vota "për", 6 vota "kundër" të tjerët nuk morën pjesë në votim e futi në rend dite Deklaratën që Lulëkuqja me Katër Petale të bëhet simbol i gjenocidit në Kosovë.**

Në vijim të mbledhjes disa nga anëtarët e grupeve kuvendare të PDK-së, LDK-së LVV-së dhe, lëshuan sallën e mbledhjes dhe atë si më poshtë:

Ilmi Azemi, Adnan Lahu, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Bujar Pllana, Edona Gashi, Gentiana Rama, Refik Maloku, Leonora Gërguri, Mek Selaci, Shkelzen Xhaferi, Sylejman Meholli dhe Ymer Haradinaj.

Në sallë ishin të pranishëm 18 anëtarë të kuvendit, andaj kryesuesja e kuvendit konstatoj se ka kuorum të mjaftueshme për vazhdimin e punimeve të mbledhjes dhe për marrjen e vendimeve të plotfuqishme.

**Në fund të debatit jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, kuvendi pas votimit me 17 vota "për" 1 votë "kundër" aprovoi këtë:**

## R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 24 nëntor 2022;
2. Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023;
3. Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2023;
4. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë – OJQ dhe Ndihmë Momentale Personave Fizikë;

5. Shqyrtimi i Draft – rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Bursave për Studentë, Nxënës dhe Shpërblime për Nxënës nr. 45/20 e datës 28.5.2020;
6. Shqyrtimi i Draft – rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë;
7. Shqyrtimi i Propozim – Vendimit për caktimin e lartësisë së pagesës për fëmijë parashkollorë në çerdhen e fëmijëve "Foleja" në Vushtrri;
8. Shqyrtimi i Nismës për bashkëpunim ndërkomunal në mes të Komunës së Vushtrrisë, Mitrovicës dhe Skënderajt;
9. Shqyrtimi i Raportit për zbatimin e Planit të Integritetit për vitin 2022;
10. Shqyrtimi i Informatës për shërbimet sociale dhe të asistencës në Komunën e Vushtrrisë;
11. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për aprovimin e listës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës për vitin 2023;
12. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për aprovim të Planit Lokal për Veprim në Mjedis për Komunën e Vushtrrisë 2022 – 2026;
13. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës të Komunës së Vushtrri me numër të protokollit Nr.236/20 i datës 26.11.2020 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq Dega në Vushtrri;
14. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktim të lokacionit për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq;
15. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshimin e vendimit me numër të protokollit Nr.192/22 i datës 28.07.2022, për zhvillimin e projektit me bashkëfinancim;
16. Shqyrtimi i Planit të Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023;
17. Shqyrtimi i Deklaratës që Lulëkuqja me Katër Petale të bëhet simbol i gjenocidit në Kosovë;
18. Të ndryshme.

**1.** Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 24 nëntor 2022;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me 18 vota "për" aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 24 nëntor 2022.**

**2.** Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 17 vota "për", 1 votë "kundër", aprovoj Planin e Punës të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2023.**

**3.** Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2023;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 18 vota "për" sa edhe ishin të pranishëm në sallën e mbledhjes, aprovoj Planin e Punës të Kryetarit të Komunës për vitin 2023.**

**4.** Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë – OJQ dhe Ndihmë Momentale Personave Fizikë;

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**falënderoj komisionin për punën që kanë bërë në hartimin e kësaj rregulloreje, por edhe të rregullores për ndarjen e bursave për studentët, dhe shtoj se më që kjo pikë ka hyrë në rendin e ditës, le të diskutohet ashtu që le ti merr imputet e nevojshme, por kërkoj që këto dy draft-rregullore të kthehen edhe njëherë për korrigjim dhe plotësim në disa aspektet të tyre. Ai kërkoj që këto dy draft-rregullore të mos aprovohet sot për në mbledhjen e radhës.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 17 vota "për", 1 votë "kundër", vendosi që Draft-rregullorja për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë – OJQ dhe Ndihmë Momentale Personave Fizikë të mos aprovohet *(shtyhet për mbledhjen e radhës)*.**

**5.** Shqyrtimi i Draft – rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Bursave për Studentë, Nxënës dhe Shpërblime për Nxënës nr. 45/20 e datës 28.5.2020;

**Galip Avdiu, anëtar i kuvendit-** pasi i përshëndeti të pranishmit tha se ndryshimi i rregullores për dhënien e bursave për student, nxënës dhe shpërblime për nxënës, është pa si e nevojshme dhe e domosdoshme me të vetmen arsye që përkrahja e studentëve dhe nxënësve të jetë sa më e madhe dhe efektive në kohë të caktuar. Qeverisja aktuale nën udhëheqjen e kryetarit Ferit Idrizi, ashtu siç është premtuar, e ka prioritet mbi çdo prioritet përkrahjen e rinisë, përkrahjen e studentëve, përkrahjen e nxënësve, shpërblimin e atyre që garojnë e që tregojnë rezultate. Këtë e ka dëshmua edhe viti që po e lemë pas, u rrit numri i bursave, u dhanë shpërblime për nxënësit garues të niveleve të ndryshme. Mirëpo, rregullorja e deritashme i ka pasur pengesat e veta, e pikërisht për këtë arsye edhe po bëhet ndryshimi i saj. Si pasojë në vitin që po e lemë pas, dy herë u dashtë me hap konkurs për dhënien e bursave, e kjo për arsye se rregullorja e kufizonte mundësinë që vetëm studentët me notën mesatare mbi 8, me qenë përfitues të bursës. Rregullorja e re e rregullon këtë pengesë dhe ju jep mundësi që përfitues të jenë edhe studentët me notë mesatare nën 8, por natyrisht gara do jetë e hapur e përfitues do jenë më të mirët. Me gjitha pengesat që kishte kjo rregullore për bursa e shpërblime, në vitin që po e lëmë pas, u ndan mese 70 bursa për studentë, e afër 40 shpërblime për nxënës meritor, që ishin pjesë e garave të shumta që u organizuan në nivel komunal e republikan. Nuk janë shumë, por janë më shumë se viteve të kaluara. E nuk janë të mjaftueshme, por qeverisja jonë me në krye kryetarin Ferit Idrizin jemi shumë të interesuar që rininë, studentët e nxënësit ti përkrahim e motivojmë në rrugën e dijes. Të nderuar, për aq sa e kuptova në komisionin për plotësim-ndryshimin e rregullores kanë marr pjesë edhe jurist, e unë fare nuk kam dyshim në profesionalizmin e tyre. Megjithatë, ka disa çështje ku mendoj që nuk e kanë vendin në rregullore, e po ashtu disa pika edhe ti bashkëngjiten. Bie fjala, Neni 5, pika 14 thotë: Studenti i cili i përket komuniteteve jo shumicë vlerësohet me 5 pikë. Pse duhej bërë dallime të studentëve garues për bursa mbi baza etnike. Mendoj që kjo pikë është e panevojshme. Në Republikën e Kosovës të gjithë qytetarët, pra edhe studentët duhet trajtuar barabartë, nuk ka privilegje, sepse duke ju dhënë privilegje, disa nga ta po lazdrohen e nuk po njohin realitetin ekzistues në Kosovë. Madje jo vetëm për bursa, por edhe për pranim të studentëve në Universitetin e Prishtinës (edhe pse kjo nuk është në kompetencën e komunës), po krijon një standardë të dyfishtë, e anashkalon garën, e aq më keq nxit studentët e komunitetit shumicë, që për ti realizuar qëllimet e tyre, të aplikojnë me kuotën e studentëve nga komuniteti pakicë.

Në rregulloren e re, nuk e di sa ju ka dhënë mundësia që përfitues të bursave me qenë edhe studentët e studimeve master. Me sa e pashë unë jo. Tashmë është e domosdoshme mi pas të mbaruara studimet master, madje në disa institucione as që mundesh me u punësua pa e mare këtë kualifikim. Po ashtu vlen të theksohet se edhe studentët dhe nxënësit që studiojnë jashtë vendit, kanë nevojë të përkrahen nga institucionet tona, e nuk e di kjo rregullore a ju ka dhanë mundësi me pas ata këtë të drejtë. Në një nga seancat pata propozuar që të ndahen së paku 10 mi euro për bursa studentëve jashtë vendi, por kjo rregullore me gjasë do të del si pengesë, nëse nuk e ndryshojmë. Një çështje tjetër që kisha propozuar është edhe mundësia që në fondin për bursa e shpërblime të kontribuojnë edhe bizneset. Pse mos të krijohet një fond shumë më i madh. Besoj që edhe bizneset do jenë të gatshme për ti përkrahur studentët dhe nxënësit meritor. Mjafton të mos ketë pengesa në këtë drejtim, të krijohen mundësi bashkëpunimi me bizneset dhe rezultatet do jenë evidente. Kërkoj nga komisioni që ti merr parasysh këto sugjerime dhe ti inkorporojë në rregullore.
**Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-**propozoi që tek neni 5 ku riformulohet neni 10 me sa vijon: pas pikës 5 të shtohet edhe <të kenë të drejt të konkurrojnë edhe studentet me notën 6 >, pastaj mendon se nuk duhet të kemi ndarje në komunitete sepse kjo nuk i bënë nder asnjërit prej komuniteteve në diskriminimin pozitiv siç edhe janë në realitet. Gjithashtu propozoi që të shtohet: studentet gra që janë edhe nëna të vlerësohen me dhjetë (10) pikë shtesë.
**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit-**propozoi që tek neni 5 i kësaj draft-rregulloreje pika 7 fëmijët e të burgosurve politik që konkurrojnë për përfitim të bursës të jenë të barabartë me pikë sikurse tek pika 6 tek fëmijët e që kanë prindërit dëshmorë (të kemi kritere të njëjta).

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 18 vota "për", vendosi që Draft-rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Bursave për Studentë, Nxënës dhe Shpërblime për Nxënës nr. 45/20 e datës 28.5.2020, të mos aprovohet *(shtyhet për mbledhjen e radhës)*.**

**6.** Shqyrtimi i Draft – rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 16 vota "për", 2 vota "abstenim" aprovoj Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë.**

**7.** Shqyrtimi i Propozim – Vendimit për caktimin e lartësisë së pagesës për fëmijë parashkollorë në çerdhen e fëmijëve "Foleja" në Vushtrri;

**Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-**propozoi që tek pika 2 e këtij propozim-vendimi të shtohet paragrafi <qifti që ka dy fëmijë në çerdhe, për fëmijën e dytë pagesa të jetë 40 €, për fëmijën e tretë pagesa të jetë 30 €, ndërsa për fëmijën e katërt të lirohet nga pagesa>. Pastaj të shtohet lirohen nga pagesa fëmijët e nënave studente dhe nënave-vetëushqyese, që njëkohësisht janë të papuna dhe me gjendje jo të mirë ekonomiko-sociale.
**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit-**propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një periudhë prej 6 muajsh, për shkak të gjendje së rënd socio-ekonomike dhe krizës me inflacionin e larët që po mbretëron në rrethanat aktuale që po jetojmë. Andaj propozimi i tij është që çmimorja për shërbimet e çerdhes publike të jetë ashtu siç është deri tash deri në tejkalimin e kësaj gjendje.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 17 vota "për", 1 votë "abstenim" vendosi që vendimi për caktimin e lartësisë së pagesës për fëmijë parashkollorë në çerdhen e fëmijëve "Foleja" në Vushtrri, të mos e aprovojë, (të shtyhet për një periudhë prej 6 muajsh, për shkak të krizës ekonomike që po mbretëron).**

**8.** Shqyrtimi i Nismës për bashkëpunim ndërkomunal në mes të Komunës së Vushtrrisë, Mitrovicës dhe Skënderajt;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 17 vota "për", 1 votë "abstenim" vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim miratohet nisma e Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë 02Nr.1618/22 datë 07.12.2022 për bashkëpunim ndër komunal në mes të Komunës së Vushtrrisë, Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe Komunës së Skënderajt.

**2.** Autorizohet Kryetari i Komunës së Vushtrrisë që pas konsultimeve me Kryetarin e Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe Skënderajt të përgatis Draft Marrëveshjen e Mirëkuptimit për menaxhimin e integruar të mbeturinave për këto tri komuna.

**3.** Draft marrëveshja e hartuar në tekstin final, i dërgohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim bazuar në procedurat e caktuara ligjore.

**4.** Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen Zyrtare të komunës së Vushtrrisë.

**9.** Shqyrtimi i Raportit për zbatimin e Planit të Integritetit për vitin 2022;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 14 vota "për", 2 vota "kundër" të tjerat "abstenim", aprovoj Raportin për zbatimin e Planit të Integritetit për vitin 2022.**

**10.** Shqyrtimi i Informatës për shërbimet sociale dhe të asistencës në Komunën e Vushtrrisë;

**11.** Shqyrtimi i Propozim – vendimit për aprovimin e listës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës për vitin 2023;

**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit-**tha se në muajin qershor e kemi aprovuar listën për dhënien në shfrytëzim për 18 parcela, dhe pyeti se a është proceduar shpallja e ankandit për dhënien e këtyre pronave në shfrytëzim.
**Ali Januzi, anëtar i kuvendit-**tha se meqë opozita lëshoj mbledhjen, dhe kjo është shumë shqetësuese, kërkoj që pika e 11 e rendit të ditës Propozim – vendimi për aprovimin e listës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës për vitin 2023, të shtyhet për mbledhjen e radhës, kur do të jenë prezentë edhe anëtarët e kuvendit nga opozita. Në të kundërtën opozita do ta përdor këtë si alibi për ta kontestuar këtë pikë sepse është vendosur pa prezencën e opozitës.

**Ismet Gashi, udhëheqës i zyrës ligjore të Komunës-**tha se përkundër fakti se opozita lëshoj mbledhjen, është obligim ligjor i komunës që deri më datën 31.12.2022 të aprovoj listën për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës për vitin 2023, dhe e njëjta duhet të publikohet në faqen zyrtar të Komunës së Vushtrris, andaj kjo pikë e rendit të ditës nuk mund të shtyhet sepse është e afatizuar për aprovim.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 18 vota "për", vendosi me sa vijon:**

**1**.Me këtë vendim aprovohet lista e veçantë që planifikohet për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2023, parcela kadastrale P-70202044-00586-0 me sipërfaqe prej 25832m$^2$, P-70202044-00529-0 me sipërfaqe prej 15761m$^2$, P-70202044-01096-0 me sipërfaqe prej 2100m$^2$, ZK-Novolan, parcela P-70202053-00366-1 me sipërfaqe prej 25436m$^2$, ZK-Prelluzhë, parcela P-70202063-00037-0 me sipërfaqe prej 54774m$^2$, ZK-Strovc, parcela P-70202037-00051-0 me sipërfaqe prej 100543m$^2$, parcela P-70202037-00337-0 me sipërfaqe prej 55449m$^2$, parcela P-70202037-00699-0 me sipërfaqe prej 23272m$^2$, ZK-Kollë, parcela P-70202040-00431-0 me sipërfaqe prej 101525m$^2$, ZK-Dumnicë e Llugës, parcela P-70202028-00412-1 me sipërfaqe prej 35232m$^2$, parcela P-70202028-00412-4 me sipërfaqe prej 6211m$^2$, ZK-Stanovc i Poshtëm, parcela P-70202061-0079K-2 me sipërfaqe prej 14126m$^2$, ZK-Sllatinë, parcela P-70202062-0K106-1 me sipërfaqe prej 1002m$^2$, ZK-Qytezë, parcela P-70202010-00789-0 me sipërfaqe prej 28502m$^2$, ZK-Bukosh, parcela P-70202035-00474-0 me sipërfaqe prej 29693m$^2$, ZK-Liqen, parcela P-70202035-00482-0 me sipërfaqe prej 39838m$^2$, ZK-Liqen, parcela P-70202035-00483-0 me sipërfaqe prej 13638m$^2$, ZK-Liqen,pjesë nga parcela kadastrale P-70202011-00435-27, në sipërfaqe prej 2000m$^2$, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 69457m$^2$, ZK Lummadh, lokalet afariste në sheshin "Hasan Prishtina" në Vushtrri (14 lokale me sipërfaqe prej 12m2), parcela P-70202050-00912-0 me sipërfaqe prej 39631m2, zk Pasomë, parcela P-70202047-00343-0, me sipërfaqe prej 87873m2, zk Akrashticë, parcela P-70202046-00508-1 me sipërfaqe prej 1065m2, zk Maxhunaj, parcela P-70202071-0 në sipërfaqe prej 11379m2, zk Shtitaricë.

**1.1** Parcela kadastrale P-70202044-00586-0 me sipërfaqe prej 25832m$^2$, P-70202044-00529-0 me sipërfaqe prej 15761m$^2$, P-70202044-01096-0 me sipërfaqe prej 2100m$^2$, ZK Novolan, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.

**1.2** Parcela P-70202053-00366-1 me sipërfaqe prej 25436m$^2$, ZK-Prelluzhë, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.

**1.3** Parcela P-70202063-00037-0 me sipërfaqe prej 54774m$^2$, ZK-Strovc, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.

**1.4** Parcela P-70202037-00051-0 me sipërfaqe prej 100543m$^2$, parcela P-70202037-00337-0 me sipërfaqe prej 55449m$^2$, parcela P-70202037-00699-0 me sipërfaqe prej 23272m$^2$, ZK-Kollë, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.

**1.5** Parcela P-70202040-00431-0 me sipërfaqe prej 101525m$^2$, ZK-Dumnicë e Llugës, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.

**1.6** Parcela P-70202028-00412-1 me sipërfaqe prej 35232m$^2$, ZK-Stanoc i Poshtëm, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.

**1.7** Parcela P-70202028-00412-4 me sipërfaqe prej 6211m$^2$, ZK-Stanoc i Poshtëm, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari afariste.

**1.8** Parcela P-70202061-0079K-2 me sipërfaqe prej 14126m$^2$, ZK-Sllatinë, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.

**1.9** Parcela P-70202062-0K106-1 me sipërfaqe prej 1002m$^2$, ZK-Qytezë, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari afariste.

**1.10** Parcela P-70202010-00789-0 me sipërfaqe prej 28502m$^2$, ZK-Bukosh, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.

**1.11** Parcela P-70202035-00474-0 me sipërfaqe prej 29693m$^2$, ZK-Liqen, parcela P-70202035-00482-0 me sipërfaqe prej 39838m$^2$, ZK-Liqen, parcela P-70202035-00483-0 me sipërfaqe prej 13638m$^2$, ZK-Liqen, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.

**1.12** Pjesë e parcelës P-70202011-00435-27 me sipërfaqe prej 2000m$^2$, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 69457m$^2$, ZK-Lummadh, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari afariste.

**1.13** Lokalet afariste (14 lokale afariste me sipërfaqe prej 12m2) që gjenden në sheshin “Hasan Prishtina” në Vushtrri në parcelën kadastrale P-70202016-00653-0, ZK Vushtrri, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari afariste.

**1.14** Parcela P-70202050-00912-0 me sipërfaqe prej 39631m2, ZK-Pasomë, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.

**1.15** Parcela P-70202047-00343-0 me sipërfaqe prej 87873m2, ZK-Akrashticë, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.

**1.16** Parcela P-70202046-00508-1-0 me sipërfaqe prej 1065m2, ZK-Maxhunaj, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.

**1.17** Parcela P-70202071-00461-0 me sipërfaqe prej 11379m2, ZK-Shtitaricë, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.

**2.** Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të zhvilloj procedurat për shpalljen e ankandit publik për pronat nga nënpika 1.1 deri 1.12. Për pronën në nënpikën 1.13 të zhvillohen procedurat e negocimit për dhënie në shfrytëzim. Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimin e të gjitha kontratave pas lidhjes së tyre.

**3**. Pjesë përbërëse e këtij vendimi paraprak janë: certifikatat e pronës dhe kopjet e planit.

**4.** Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**12.** Shqyrtimi i Propozim – vendimit për aprovim të Planit Lokal për Veprim në Mjedis për Komunën e Vushtrrisë 2022 – 2026;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 18 vota "për", vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim miratohet Plani Lokal për Veprim në Mjedis për Komunën e Vushtrrisë 2022-2026.

**2.** Për zbatimin e këtij Plani obligohen Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

**3.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani Lokal për Veprim në Mjedis për Komunën e Vushtrrisë 2022-2026.

**4.** Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**13.** Shqyrtimi i Propozim – vendimit për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës të Komunës së Vushtrri me numër të protokollit Nr.236/20 i datës 26.11.2020 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq Dega në Vushtrri;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 18 vota "për", vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim shfuqizohet Vendimi 01.Nr.236/20, dt.26.11.2020, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq-Dega në Vushtrri, në pjesë të parcelës kadastrale P-K4103-1, në sipërfaqe prej 250 m2, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 5696 m2, Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e Kooperativa Bujqësore në Vushtrrisë.

2.Me këtë vendim njoftohen Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenë Sociale, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Ambientit.

3.Ky Vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**14.** Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktim të lokacionit për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq;

**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit-**propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës, pasi që kërkesa e parashtruar nga përfaqësuesit e Kryqit të Kuq është e mangët, nuk i plotëson kriteret që duhet ti ketë një kërkesë, kjo për faktin se këta të fundit kanë kërkuar, ndarjen e një prone prej 5 ari sipërfaqe tokësore, por nuk kanë prezantuar projekt për ndërtimin e këtij objekti, nuk kanë dorëzuar planë ideor dhe paramasë dhe parallogari. Më pas paraqiti vërejtjet e tij edhe tek Drejtoria për Pronë, e cila nuk ka përcaktuar saktë se në cilën pjesë të kësaj parcele do të ndërtohet ky objekt.
**Remzi Ahmeti, drejtor i DGJKP-së-**tha se duhet të bëhen analiza urbanistike për sa i përket kësaj çështje dhe më tej të procedohet kjo çështje për aprovim.
**Ali Januzi, anëtar i kuvendit-**kërkoj që të jepen sqarime nga Drejtoria e Pronës, e cila ku gjendet ai lokacion që po mendohet të jepet për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq, si dhe të jepen karakteristikat për lidhur me këtë parcelë, ashtu që të kemi një mendim të saktë para se të votojmë këtë çështje.
**Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-**sqaroi se kanë pasur takim me përfaqësuesit e Kryqit të Kuq të Kosovës, dhe janë të pajtimit që atyre tu ndahet një lokacion për ndërtimin e një objekti të ri për zhvillimin e veprimtarisë të kësaj organizate. Tutje arsyetoj se Drejtoria e Pronës nuk ka arritur të bëjë si duhet identifikimin dhe ndarjen fizike të asaj prone, nga tërësia në sipërfaqe të caktuar që nevojitet për ndërtimin e atij objekti. Andaj kërkoj mirëkuptimin e kuvendit që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës me të dhëna të sakta të ndarjes fizike të parcelës.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 14 vota "për", 2 vota "kundër" 1 votë "abstenim" vendosi që propozim-vendimi për caktim të lokacionit për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq, të shtyhet për mbledhjen e muajt janar 2023.**

**15.** Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshimin e vendimit me numër të protokollit Nr.192/22 i datës 28.07.2022, për zhvillimin e projektit me bashkëfinancim;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 17 vota "për", 1 votë "abstenim" vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim, ndryshohet dhe plotësohet vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr.192/22, dt. 28.07.2022, pika 2 e vendimit dhe formulohet me tekst si në vijim: **"Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të vendimit bazë do të merren nga buxheti i zyrës së kryetarit të komunës, kategoria subvencione dhe transfere, ndërsa pjesa tjetër e mjeteve do të sigurohen nga participimi i qytetarëve të atij lokaliteti".**

**2.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të komunës.

**3.** Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen Zyrtare të komunës së Vushtrrisë.

**16.** Shqyrtimi i Planit të Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 18 vota "për", aprovoj Planin e Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023.**

1**7.** Shqyrtimi i Deklaratës që Lulëkuqja me Katër Petale të bëhet simbol i gjenocidit në Kosovë;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 17 vota "për" 1 votë "kundër" aprovoj këtë:**

**DEKLARATË**

**1.** Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë përkrah dhe mbështet idenë respektivisht kërkesën e Qendrës "Gjenocidi në Kosovë-Plagë e Hapur", që Lulëkuqja me katër petale, të jetë simbol i viktimave të gjenocidit në Kosovë dhe kësisoj lulëkuqja me katër petale të bëhet simbol unik i përkujtimit të gjenocidit në Kosovë.

**2.** Kuvendi i Komunës konsideron që katër petalet e Lulëkuqes, në logon e dizajnuar paraqesin qartë katër format e akteve gjenocidale që Serbia zbatoi në Kosovë: vrasjen, dhunën seksuale, spastrimin etnik dhe shkatërrimin e objekteve që lidhen me përkatësinë etnike dhe identitetin shqiptar.

**Vushtrri,**

**29 dhjetor 2022**

**Mbledhja përfundoi në ora: 14:40.**

| | |
|---|---|
| **Bastri Duraku** | **Melihate Basholli-Latifi** |
| ______________________ | ___________________________ |
| **Procesmbajtës** | **Kryesuese e Kuvendit** |

REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA VUSHTRRI

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | 10.01.2023 |
| **PËR/ZA/TO:** | KPF dhe Kuvendin e Komunës |
| **PËRMES** | Ferit Idrizit, Kryetar i Komunës |
| **NGA/OD/FROM:** | Isuf Jashari Drejtor për Buxhet dhe Financa |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | Raport i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2022 |

Të nderuar anëtarë të KPF-së dhe KK-së. Bazuar në planin e punës për vitin 2022 ju prezantojmë Raportin e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2022

Me respekt!

Shtojcë raportet:
Tabelaret.

Emri i Komunës : **K.K.VUSHTRRI**

Kodi i Komunës: **644**

Periudha raportuese **Janar - Shtator 2022**

## TE HYRAT VETANAKE (THV) SIPAS DREJTORIVE DHE KODIT EKONOMIK

| Përshkrimi | Kodi | Periudha raportuese | | | Vjetore | | | | Viti i kaluar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Buxheti i planifikuar për PR | Të hyrat e realizuar në PR | Përqindja e buxhet të realizuar për PR | Buxheti I planifikuar për 2022 | Buxheti I mbetur për 2022 | Plani I reviduar | Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar | Te hyrat e realizuara ne periudhen e njejte 2021 |
| | | 4 | 5 | 6 = 5/4*100 | 7 | 8= 7-5 | 9 | 10 = 7-9 | 11 |
| **Administrata dhe personeli** | **163** | € | € | % | € | € | € | € | € |
| Taksa administrative | | 52,500.00 | 57,353.00 | **109%** | 70,000.00 | **12,647.00** | 0.00 | **70,000.00** | 55,118.00 |
| TOTAL | | **52,500.00** | **57,353.00** | 109% | **70,000.00** | **12,647.00** | **0.00** | **70,000.00** | **55,118.00** |
| | | | | | | | | | |
| **Inspeksioni** | **166** | € | € | % | € | € | € | € | € |
| Pranime teknike | | 3,750.00 | 4,120.00 | **110%** | 5,000.00 | **880.00** | 0.00 | **5,000.00** | 2,418.00 |
| Pelqimet sanitare | | 4,500.00 | | **0%** | 6,000.00 | **6,000.00** | 0.00 | **6,000.00** | 12,674.78 |
| Gjobat e inspeksionit | | 750.00 | 1,825.00 | **243%** | 1,000.00 | **-825.00** | 0.00 | **1,000.00** | 7,787.16 |
| TOTAL | | **9,000.00** | **5,945.00** | **66%** | **12,000.00** | **6,055.00** | **0.00** | **12,000.00** | **22,879.94** |
| | | | | | | | | | |
| **Buxhet dhe Financa** | **175** | € | € | % | € | € | € | € | € |
| Taksat e firmave | | 7,500.00 | 16,500.00 | **220%** | 10,000.00 | **-6,500.00** | 0.00 | **10,000.00** | 14,840.00 |
| Tatimi në pronë | | 794,751.75 | 719,835.13 | **91%** | 1,059,669.00 | **339,833.87** | 0.00 | **1,059,669.00** | 741,973.28 |
| TOTAL | | **802,251.75** | **736,335.13** | **92%** | **1,069,669.00** | **333,333.87** | **0.00** | **1,069,669.00** | **756,813.28** |
| | | | | | | | | | |
| **Arsimi** | **900** | € | € | % | € | € | € | € | € |
| **Shitja e prodhimeve** | | | | | | | | | |
| Participimi në çerdhen e fëmijëve | | 33,750.00 | 24,562.00 | **73%** | 45,000.00 | **20,438.00** | 0.00 | **45,000.00** | 15,692.00 |
| Shkolla e Mesme Teknike | | 11,250.00 | 10,763.00 | **96%** | 15,000.00 | **4,237.00** | 0.00 | **15,000.00** | 8,129.00 |
| Shkolla e Mesme Profesionale | | 10,500.00 | 10,990.00 | **105%** | 14,000.00 | **3,010.00** | 0.00 | **14,000.00** | 10,971.00 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| TOTAL | | 55,500.00 | 46,315.00 | 83% | 74,000.00 | 27,685.00 | 0.00 | 74,000.00 | 34,792.00 |
| | | | | | | | | | |
| **Gjeodezi dhe Kadastër** | **650** | € | € | % | € | € | € | € | € |
| Të hyrat nga Gjeodezia dhe Kadastri | | 30,000.00 | 98,259.00 | 328% | 23,000.00 | -75,259.00 | 0.00 | 23,000.00 | 87,008.62 |
| Qiraja nga objektet publike | | 17,250.00 | 2,155.00 | 12% | 40,000.00 | 37,845.00 | 0.00 | 40,000.00 | 2,155.00 |
| TOTAL | | 47,250.00 | 100,414.00 | 213% | 63,000.00 | -37,414.00 | 0.00 | 63,000.00 | 89,163.62 |
| | | | | | | | | | |
| **Kulturë, rini dhe sport** | **850** | € | € | % | € | € | € | € | € |
| Palestra e sportit | | 750.00 | 132.00 | 18% | 1,000.00 | 868.00 | 0.00 | 1,000.00 | 552.00 |
| Biblioteka | | 375.00 | | 0% | 500.00 | 500.00 | 0.00 | 500.00 | 46.00 |
| Shtëpia e Kulturës | | 750.00 | 41.40 | 6% | 1,000.00 | 958.60 | 0.00 | 1,000.00 | 295.00 |
| TOTAL | | 1,875.00 | 173.40 | 9% | 2,500.00 | 2,326.60 | 0.00 | 2,500.00 | 893.00 |
| | | | | | | | | | |
| **Shërbime publike** | **180** | € | € | % | € | € | € | € | € |
| Parkingjet | | 1,500.00 | 3,632.00 | 242% | 2,000.00 | -1,632.00 | 0.00 | 2,000.00 | 1,230.00 |
| Regjistrimi I automjeteve | | 62,250.00 | 100,681.00 | 162% | 83,000.00 | -17,681.00 | 0.00 | 83,000.00 | 95,680.50 |
| Taksat e mbeturinave | | 460,300.50 | 317,264.02 | 69% | 613,734.00 | 296,469.98 | 0.00 | 613,734.00 | 375,500.40 |
| TOTAL | | 524,050.50 | 421,577.02 | 80% | 698,734.00 | 277,156.98 | 0.00 | 698,734.00 | 472,410.90 |
| **Prokurimi** | | | | | | | | | 29,994.60 |
| **Bujqësi** | **470** | € | € | % | € | € | € | € | € |
| Ndryshimi i destinimit të tokës | | 7,500.00 | 29,948.00 | 399% | 10,000.00 | -19,948.00 | 0.00 | 10,000.00 | 61,615.19 |
| Shitja e Drujve | | | 630.00 | | | | | | |
| Leje pune | | | 160.00 | | | | | | 30.00 |
| TOTAL | | 7,500.00 | 30,738.00 | 410% | 10,000.00 | -19,948.00 | 0.00 | 10,000.00 | 61,645.19 |
| | | | | | | | | | |
| **Shëndetësi** | **700** | € | € | % | € | € | € | € | € |
| Participim | | 37,500.00 | 36,463.50 | 97% | 50,000.00 | 13,536.50 | 0.00 | 50,000.00 | 40,187.50 |
| Paricipim QPS | | 1,500.00 | 2,830.00 | 189% | 2,000.00 | -830.00 | 0.00 | 2,000.00 | 2,626.00 |
| TOTAL | | 39,000.00 | 39,293.50 | 101% | 52,000.00 | 12,706.50 | 0.00 | 52,000.00 | 42,813.50 |
| | | | | | | | | | |
| **Urbanizmi** | **660** | € | € | % | € | € | € | € | € |
| Lejet e ndërtimit | | 154,419.00 | 465,459.63 | 301% | 205,892.00 | -259,567.63 | 0.00 | 205,892.00 | 432,444.56 |
| leje mjedisore | | | 24,196.82 | | | | | | 40,230.54 |
| Legalizim I Objekteve | | | 10,956.77 | | | | | | 6,600.64 |
| Rrenim I objekteve | | | 574.56 | | | | | | 406.56 |
| Shfrytëzimi i pronës Publike | | 3,750.00 | 6,758.20 | 180% | 5,000.00 | -1,758.20 | 0.00 | 5,000.00 | 1,210.00 |
| TOTAL | | 158,169.00 | 507,945.98 | 321% | 210,892.00 | -261,325.83 | 0.00 | 210,892.00 | 480,892.30 |
| | | | | | | | | | |
| | **850** | € | € | % | € | € | € | € | € |
| Gjobat e pyjeve | | | 50.00 | | | | | | |
| Të hyrat tjera | | | 29,973.00 | #VALUE! | | -29,973.00 | 0.00 | 0.00 | 30,035.73 |
| TOTAL | | 0.00 | 30,023.00 | #DIV/0! | 0.00 | -29,973.00 | 0.00 | 0.00 | 30,035.73 |
| | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1,697,096.25 | 1,976,113.03 | 116% | 2,262,795.00 | 286,681.97 | 0.00 | 2,262,795.00 | 2,077,452.06 |

| | |
|---|---|
| #REF! | K.K.Vushtrri |
| #REF! | 644 |
| Periudha raportuese | Janar - Dhjetor 2022 |

## PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS BURIMIT TË FINANCIMIT

*Ndërtimi I rrjetit të ujësjellësit me rezervuar për fsht*

| PËRSHKRIMI | KODI | PERIUDHA RAPORTUESE | | | VJETORE | | | | Viti I kaluar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | BUXHETI I PLANIFIIKUAR | Shpenzimet të realizuar në PR | Përqindja e nuxhetit të alokuar | Buxheti I planifikuar për 2022 | Buxheti I mbetur për 2022 | Plani I reviduar 2022 | Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar | Shpenzimi I realizuar për periudhën e njëjtë 2021 |
| | | 4 | 5 | 6 = 5/4*100 | 7 | 8= 7-5 | 9 | 10 = 7-9 | 11 |
| | | € | € | % | € | € | € | € | € |
| Finacimi nga huamarrjet | 04 | 158,055.91 | 158,055.91 | 100% | 158,055.91 | 0.00 | 0.00 | 158,055.91 | 52,937.32 |
| Granti Qeveritar | 10 | 17,614,141.64 | 15,284,214.97 | 87% | 17,614,141.64 | 2,329,926.67 | 0.00 | 17,614,141.64 | 15,663,820.05 |
| Të hyrat vetanake | 21 | 2,262,795.00 | 1,399,805.00 | 62% | 2,262,795.00 | 862,990.00 | 0.00 | 2,262,795.00 | 1,086,127.98 |
| Mjetet e bartura | 22 | 2,574,011.71 | 1,427,598.28 | 55% | 2,574,011.71 | 1,146,413.43 | 0.00 | 2,574,011.71 | 1,176,102.73 |
| Donacionet e brendshme | 31 | 52,001.23 | 46,530.00 | 89% | 52,001.23 | 5,471.23 | 0.00 | 52,001.23 | 17,479.95 |
| Donacionet e jashtme | 32 | 42,099.39 | 22,413.22 | 53% | 42,099.39 | 19,686.17 | 0.00 | 42,099.39 | 301,757.87 |
| TOTALI | | 22,703,104.88 | 18,338,617.38 | 81% | 22,703,104.88 | 4,364,487.50 | 0.00 | 22,703,104.88 | 18,298,225.90 |

Sqarim:

Granti Qeveritar kodi ekonomik 10,Buxheti I planifikuar është 17,614,141.64euro,Buxheti I shpenzuar është 15,284,214.97euro,Realizimi është 87%

Të hyrat vetanake kodi ekonomik 21,Buxheti I planifikuar është 2,262,795euro,Buxheti I shpenzuar është 1399805euro,Realizimi është 62%

Mjetet e bartura kodi ekonomik 22,Buxheti I planifikuar është 442,504.93euro,Buxheti I shpenzuar është 381,074.87euro,Realizimi është 86%

Donacionet e brendeshme kodi ekonomik 31,Buxheti I planifikuar është 52,001.23euro,Buxheti I shpenzuar është 46,530.00euro,Realizimi është 89%

Donacionet e jashtme kodi ekonomik 32,Buxheti I planifikuar është 42,099.39euro,Buxheti I shpenzuar është 22,413.22euro,Realizimi është 53%

**Konklodojm se Buxheti I planifikuar është 22,703,104.88euro,Buxheti I shpenzuar është 18,338,617.38 euro,Realizimi është 81%**

| | |
|---|---|
| Komuna | VUSHTRRI |
| Kodi | 644 |
| Periudha raportuese | Janar - Dhjetor 2022 |

## PËRMLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE TË LARTA TË SHPENZIMEVE

| PËRSHKRIMI | KODI | PERIUDHA RAPORTUESE | | | VJETORE | | | | Viti I kaluar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | BUXHETI I PLANIFIIKUAR | Shpenzimet të realizuar në PR | Përqindja e nuxhetit të alokuar | Buxheti I planifikuar për 2022 | Buxheti I mbetur për 2022 | Plani I reviduar 2022 | Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar | Shpenzimi I realizuar për periudhën e njëjtë 2021 |
| | | 4 | 5 | 6 = 5/4*100 | 7 | 8= 7-5 | 9 | 10 = 7-9 | 11 |
| | | € | € | % | € | € | € | € | € |
| Paga dhe mëditje | 111 | 10,892,106.55 | 10,100,513.53 | 93% | 10,892,106.55 | 791,593.02 | 0.00 | 10,892,106.55 | 10,603,183.40 |
| Mallra dhe shërbime | 130 | 3,955,236.98 | 3,317,493.01 | 84% | 3,955,236.98 | 637,743.97 | 0.00 | 3,955,236.98 | 3,110,540.88 |
| Shpenzimet komunale | 132 | 442,504.93 | 381,074.87 | 86% | 442,504.93 | 61,430.06 | 0.00 | 442,504.93 | 309,362.05 |
| Subvencionet dhe transferet | 200 | 1,365,940.00 | 1,183,529.05 | 87% | 1,365,940.00 | 182,410.95 | 0.00 | 1,365,940.00 | 836,991.44 |
| Investimet kapitale | 300 | 6,042,316.42 | 3,356,006.92 | 56% | 6,042,316.42 | 2,686,309.50 | 0.00 | 6,042,316.42 | 3,438,148.13 |
| Rezerva | | 5,000.00 | 0.00 | | 5,000.00 | 5,000.00 | | 5,000.00 | |
| TOTALI | | 22,703,104.88 | 18,338,617.38 | 81% | 22,703,104.88 | 4,364,487.50 | 0.00 | | 18,298,225.90 |

Sqarim:

Paga dhe mëditje kodi ekonomik 111,Buxheti I planifikuar është 10,892,106.55euro,Buxheti I shpenzuar është 10,100,513.53euro,Realizimi është 93%

Mallra dhe shërbime kodi ekonomik 130,Buxheti I planifikuar është 3,955,236.98euro,Buxheti I shpenzuar është 3,317,493.01euro,Realizimi është 84%

Shpenzimet komunale kodi ekonomik 132,Buxheti I planifikuar është 442,504.93euro,Buxheti I shpenzuar është 381,074.87euro,Realizimi është 86%

Subvencionet dhe transferet kodi ekonomik 200,Buxheti I planifikuar është1,365,940.00euro,Buxheti I shpenzuar është 1,183,529.05euro,Realizimi është 87%

Investimet kapitale kodi ekonomik 300,Buxheti I planifikuar është 6,042,316.42euro,Buxheti I shpenzuar është 3,356,006.92euro,Realizimi është 56%

Rezerva,Buxheti I planifikuar është 5,000.00euro,Buxheti I shpenzuar është 0.00 euro.

**Konklodojm se Buxheti I planifikuar është 22,703,104.88euro,Buxheti I shpenzuar është 18,338,617.38 euro,Realizimi është 81%**

Emri i Komunës : VUSHTRRI

Kodi i Komunës: 644

Janar - Dhjetor 2022

Periudha raportuese

## PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS DREJTORIVE

| PËRSHKRIMI | KODI | PERIUDHA RAPORTUESE | | | VJETORE | | | | Viti I kaluar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | BUXHETI I PLANIFIIKUAR | Shpenzimet të realizuar në PR | Përqindja e nuxhetit të alokuar | Buxheti I planifikuar për 2022 | Buxheti I mbetur për 2022 | Plani I reviduar 2022 | Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar | Shpenzimi I realizuar për periudhën e njëjtë 2021 |
| | | € | € | % | € | € | € | € | € |
| Zyra e Kryetarit | 160 | 457,218.00 | 370,896.13 | 81% | 457,218.00 | 86,321.87 | 0.00 | 457,218.00 | 429,092.93 |
| Administrata dhe personeli | 163 | 779,758.00 | 561,569.19 | 72% | 779,758.00 | 218,188.81 | 0.00 | 779,758.00 | 347,928.08 |
| Inspektimet | 166 | 142,815.00 | 90,006.24 | 63% | 142,815.00 | 52,808.76 | 0.00 | 142,815.00 | 112,198.99 |
| Prokurimi | 167 | 55,918.00 | 31,985.72 | 57% | 55,918.00 | 23,932.28 | 0.00 | 55,918.00 | 31,663.96 |
| Zyra e Kuvendit Komunal | 169 | 143,451.00 | 136,726.56 | 95% | 143,451.00 | 6,724.44 | 0.00 | 143,451.00 | 135,142.11 |
| Buxheti dhe financat | 175 | 210,676.00 | 168,331.28 | 80% | 210,676.00 | 42,344.72 | 0.00 | 210,676.00 | 156,479.27 |
| Shërbimet publike, Mbrojtja civile dhe emergjenca | 180 | 3,732,956.60 | 3,106,846.73 | 83% | 3,732,956.60 | 626,109.87 | 0.00 | 3,732,956.60 | 3,509,000.37 |
| Zyra lokale e komuniteteve | 195 | 81,871.00 | 55,279.92 | 68% | 81,871.00 | 26,591.08 | 0.00 | 81,871.00 | 41,408.56 |
| Bujqësi, pylltari, zhvillimi rural | 470 | 1,113,299.67 | 543,019.14 | 49% | 1,113,299.67 | 570,280.53 | 0.00 | 1,113,299.67 | 474,938.40 |
| Gjeodezi dhe Kadastër | 650 | 105,497.00 | 75,274.48 | 71% | 105,497.00 | 30,222.52 | 0.00 | 105,497.00 | 77,598.40 |
| Planifikimi urban dhe mjedisi | 660 | 1,680,389.49 | 986,703.83 | 59% | 1,680,389.49 | 693,685.66 | 0.00 | 1,680,389.49 | 1,059,664.57 |
| Shëndetësia primare | 730 | 3,277,487.14 | 2,483,479.58 | 76% | 3,277,487.14 | 794,007.56 | 0.00 | 3,277,487.14 | 2,398,442.71 |
| Shërbimet sociale rezidenciale | | 339,459.00 | 217,759.93 | 64% | 339,459.00 | 121,699.07 | 0.00 | | 204,562.19 |
| Kulturë, rini, sport | 850 | 819,893.46 | 515,729.78 | 63% | 819,893.46 | 304,163.68 | 0.00 | 819,893.46 | 335,420.50 |
| Arsimi | 920 | 9,762,415.52 | 8,995,008.87 | 92% | 9,762,415.52 | 767,406.65 | 0.00 | 9,762,415.52 | 8,984,684.86 |
| **TOTALI** | | 22,703,104.88 | 18,338,617.38 | 81% | 22,703,104.88 | 4,364,487.50 | 0.00 | 22,703,104.88 | 18,298,225.90 |

Sqarim:

Përmbledhja e shpenzimeve sipas drejtorive është si vijon:

Buxheti I planifikuar është 22,703,104.88euro,buxheti I realizuar është 18,338,617.38euro shprehur në përqindje realizimi është 81% në total.

Emri i Komunës : VUSHTRRI
Kodi I komunës: 644
Periudha raportuese Janar - Dhjetor 2022

| KODI | Mallrat dhe shërbimet | 2022 | 2021 |
|---|---|---|---|
| **13130** | Shpenzimet e udhetimit zyrtar brenda vendit | 4,262.81 | 1,076.45 |
| **13132** | Akomodimi I udhetimit zyrtar brenda vendit | | 768.00 |
| **13133** | Shpenzimet e tjera të-udhetimit zyrtar brenda vendit | 765.41 | 10.76 |
| 13140 | Shpenzimet e udhetimit zyrtar jasht vendit | 3,260.18 | 700.00 |
| 13141 | Shpenzimet të vogla -para xhepi | 7,652.40 | 1,612.00 |
| 13142 | Akomodimet e udhetimit zyrtar jasht vendit | 4,050.50 | 810.00 |
| 13143 | Shpenzimet tjera e udhetimit zyrtar jasht vendit | 1,731.72 | 351.00 |
| 13310 | Shpenzimet për internet | 4,874.42 | 2,936.07 |
| 13320 | Shpenzimet e telefonisë mobile | 22,502.05 | 25,527.24 |
| 13330 | Shpenzimet postare | 13,606.46 | 12,936.53 |
| 13410 | Shpenzimet e arsimit dhe trajnimit | 9,331.00 | |
| 13420 | Sherbimet e perfaqsimit - avokaturë | 18,201.50 | 94.40 |
| 13430 | Shërbime te ndryshme shendetësore | 8,133.76 | 6,351.54 |
| 13440 | Shërbime te ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse | 541.00 | 32.00 |
| 13450 | Shërbime shtypje - jo marketing | 976.50 | |
| 13460 | Shërbime Kontraktuese Tjera | 2,002,496.30 | 1,831,096.21 |
| 13470 | Shërbime teknike | 1,800.00 | 1,867.17 |
| 13780 | Shpenzimet për antarsim | 17,480.50 | 17,480.50 |
| 13490 | Shërbimet e varrimit | | 107,460.00 |
| 13501 | Mobilje (më pak se 1000 euro) | 23,766.41 | 17,402.40 |
| 13503 | Kompjuter (më pak se 1000 euro) | 51,306.71 | 93,234.10 |
| 13504 | Harduer për teknikë informative (më pak se 1000 euro) | 39.00 | 332.36 |
| 13508 | paisje trafiku (më pak se 1000 euro) | | 363.00 |
| 13509 | paisje tjera (më pak se 1000 euro) | 76,932.56 | 63,660.57 |
| 13506 | Pajisje specialistike mjeksore | | |
| 13509 | Pajisje tjera (me pak se 1000 euro) | | |
| 13510 | blerja e librave edhe veprave artistike | | 2,399.00 |
| 13610 | Furnizime për zyrë | 132,408.45 | 93,541.68 |
| 13611 | Furnizim me dokumenta bllanko | | 5,600.00 |
| 13620 | Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare) | 149,124.13 | 29,985.35 |
| 13630 | Furnizime mjekësore | 98,133.88 | 109,423.41 |
| 13640 | Furnizime pastrimi | 38,585.15 | 23,663.01 |
| 13650 | Furnizim me veshmbathje | 14,206.50 | 13,306.00 |
| 13655 | Furnizim me preparate kimike | 2,395.00 | 2,071.50 |
| 13710 | vaj | 1,593.00 | 726.00 |
| 13720 | Nafte per ngrohje qendrore | 72,721.01 | 56,099.41 |
| 13760 | Dru | 211,248.75 | 190,589.24 |
| 13770 | Derivate per gjenerator | 5,462.79 | 2,202.06 |
| 13780 | Karburant per vetura | 62,998.48 | 42,091.28 |
| 13790 | Gas natyror | 1,276.80 | 198.65 |
| 13810 | Avanc për para të imta | 1,000.00 | 4,000.00 |
| 13820 | Avanc për udhëtime zyrtare | 30,162.83 | 2,118.53 |
| 13918 | Provizion për tarifa të ndryshme | 4,911.00 | 4,688.50 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 13950 | Regjistrimi i automjeteve | 4,635.00 | 4,075.00 |
| 13951 | Sigurimi i automjeteve | 9,353.61 | 4,843.45 |
| 14010 | Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve | 27,629.24 | 34,120.66 |
| 14020 | Mirembajtja e ndertesave | 8,453.47 | 4,271.34 |
| 14022 | Mirembajtja e ndertesave afariste | | 877.50 |
| 14023 | Mirembajtja e shkollave | 20,515.51 | 36,248.27 |
| 14024 | Mirmbajtja e objekteve shëndetësore | 3,108.94 | 7,434.03 |
| 14032 | Mirmbajtja e auto rrugeve lokale | | 20,254.20 |
| 14040 | Mirmbajtja e teknologjisë informative | 5,165.09 | 3,292.31 |
| 14050 | Mirembajtja e mobileve dhe paisjeve | 15,162.07 | 27,006.11 |
| 14060 | Mirembajtja rutinore | 14,816.00 | 83,913.40 |
| 14110 | Qiraja per ndertesa | 1,620.00 | 1,440.00 |
| 14130 | Qiraja - pajisjet | 13,294.26 | 8,318.55 |
| 14140 | Qiraja -makineria | 20,036.48 | 18,684.52 |
| 1415 | Qiraja- përdorime tjera të hapsirave | | 950.00 |
| 14210 | Reklamat dhe konkurset | | 1,742.49 |
| 14220 | Botimet e publikimeve | 5,485.50 | 1,480.02 |
| 14230 | Shpenzimet per informim publik | 9,927.80 | 15,569.60 |
| 14310 | Drekat zyrtare | 39,438.15 | 31,183.68 |
| 14410 | Shpenzime-vendimet e gjykatave | 18,612.93 | 7,271.64 |
| 14415 | Pagesat për tarifat-vendimet gjyqësore- përmbarimore | 300.00 | 2,119.28 |
| 14510 | Pagesa e tatimit në qira | | 1,878.00 |
| 17000 | Pagesa e borgjit qeveritar | | 24,760.91 |
| | **13 TOTALI PËR MALLRA DHE SHËRBIME** | **3,317,493.01** | **3,110,540.88** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **14** | | | |
| 13210 | Rryma | 293,862.17 | 231,376.25 |
| 13220 | Uji | 50,708.95 | 38,959.32 |
| 13230 | Mbeturinat | 29,262.92 | 30,581.21 |
| 13250 | Shpenzimet telefonike | 7,090.83 | 8,445.27 |
| 13260 | Pagesa-vendime gjygjësore | 150.00 | |
| | **14 TOTALI I SHPENZIMEVE KOMUNALE** | **381,074.87** | **309,362.05** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **20** | **SUBVENCIONET** | | |
| 21110 | SUBVENCIONE PËR ENTITETET PUBLIKE | 444,983.24 | 182,834.21 |
| 21200 | SUBVENCIONE PËR ENTITETET JOPUBLIKE | 696,568.33 | 654,037.23 |
| | **20 TOTALI I SUBVENCIONEVE** | **1,141,551.57** | **836,871.44** |
| | TOTALI I SHPENZIMEVE OPERATIVE | 4,840,119.45 | 4,256,774.37 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Shpenzimet për projekte kapitale | Janar - Dhjetor 2022 | | | |
| Përshkrimi | Buxheti | Shpenzimi | Shuma e mbetur | % |
| **16324 ADMINISTRATA - VUSHTRRI** | **362,200.00** | **201,111.92** | **161,088.08** | **55.53** |
| 43890 Inventar për Objektin e Ri të Komunës | 4,200.00 | 2,305.00 | 1,895.00 | 54.88 |
| 49479 NDËRTIMI I DEPOSË | 30,000.00 | 26,098.60 | 3,901.40 | 87.00 |
| 51814 Ngrohja qendrore për administratën Komunale | 97,000.00 | 69,689.97 | 27,310.03 | 71.85 |
| 51815 Motori për gjenerator ne administratën Komunale | 10,000.00 | 9,200.00 | 800.00 | 92.00 |
| 51816 Rregullimi i nyjeve sanitare në objektin e administratës Kom | 15,000.00 | 6,632.72 | 8,367.28 | 44.22 |
| 51817 Ndarja fizike e objektit ne administratën Komunale | 5,000.00 | 0.00 | 5,000.00 | 0.00 |
| 51818 Teknologjia Informative për administratën Komunale | 80,000.00 | 23,228.63 | 56,771.37 | 29.04 |
| 52186 NDËRTIMI I SALLËS NË OBJEKTIN E KOMUNËS | 121,000.00 | 63,957.00 | 57,043.00 | 52.86 |
| **17524 BUXHETI - VUSHTRRI** | **332.00** | **0.00** | **332.00** | **0.00** |
| 60405 ASFALTIMI I RRUGES PANTIN-ASHLAN | 331.00 | 0.00 | 331.00 | 0.00 |
| 60413 RIPARIM SHF KRASNIQ.POSHTME | 1.00 | 0.00 | 1.00 | 0.00 |
| **18024 SHËRBIME PUBLIKE - INFRASTRUKTURA RRUGORE - VUSHTRRI** | **3,094.59** | **0.00** | **3,094.59** | **0.00** |
| 71935 RREGULLIMI I SHESHIT HSAN PRISHTINA | 37.00 | 0.00 | 37.00 | 0.00 |
| 72228 RREGU.RRUGES BAHRI KUQI SEG.1 | 375.52 | 0.00 | 375.52 | 0.00 |
| 83124 FOND.BASHKFIN.SHTR.RR.KUBEZA | 2.00 | 0.00 | 2.00 | 0.00 |
| 86140 FONDI IBASHKFINANCIMIT SHTRURJA E RRUGVE ME KUBE | 2,576.07 | 0.00 | 2,576.07 | 0.00 |
| 93129 PTK PER RR.NE L.BUN.SOP.F.SAMA | 104.00 | 0.00 | 104.00 | 0.00 |
| **18184 INFRASTRUKTURA PUBLIKE - VUSHTRRI** | **1,890,660.01** | **1,384,940.63** | **505,719.38** | **73.25** |
| 41407 NDERTIMI I TROTUAREVE | 2,500.00 | 0.00 | 2,500.00 | 0.00 |
| 43900 Projektet në bashkëfinancim me donator | 21,194.80 | 11,909.10 | 9,285.70 | 56.19 |
| 46628 ZGJERIMI I RRJETIT TË UJËSJELLËSIT | 51,235.81 | 31,563.42 | 19,672.39 | 61.60 |
| 47962 RREGULLIMI I VARREZAVE TË MARTIRËVE | 5,192.00 | 4,237.00 | 955.00 | 81.61 |
| 51202 RINDERTIMI I RRUGEVE ME INFRASTRUKTURE | 1,125.82 | 1,124.89 | 0.93 | 99.92 |
| 51819 Ndërtimi i kanalizimeve në Vushtrri, Smadrexhë, Maxhunaj, S | 443,000.00 | 387,638.69 | 55,361.31 | 87.50 |
| 51820 Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni rr. "Skenderbeu", "Bek | 207,000.00 | 0.00 | 207,000.00 | 0.00 |
| 51821 Ndërtimi i trotuareve në Vushtrri, Stanoc, Smrekonicë | 100,000.00 | 98,041.03 | 1,958.97 | 98.04 |
| 51822 Sinjalizimi horizontal dhe vertikal rr."Dëshmorë e Kombit" | 70,000.00 | 50,000.00 | 20,000.00 | 71.43 |
| 51823 Zgjërimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatrat e Qyqavicës, | 212,100.00 | 166,220.71 | 45,879.29 | 78.37 |
| 51824 Ndërtimi i sheshit të "Qytetit", Stroc, Smrekonicë dhe parqe | 51,134.00 | 44,264.53 | 6,869.47 | 86.57 |
| 51825 Rregullimi i varrezave të qytetit-Vushtrri | 25,000.00 | 20,732.00 | 4,268.00 | 82.93 |
| 51826 Blerja e veturave për administratën komunale - Vushtrri | 55,000.00 | 0.00 | 55,000.00 | 0.00 |
| 51827 Ndërtimi i vigave mbi lumin Silnica , Tërstena dhe Stanoc | 40,000.00 | 39,999.31 | 0.69 | 100.00 |
| 51828 Rikonstruktimi i rrugëve te asfaltuara "2 Maji", "Hamit Hyse | 200,000.00 | 179,369.58 | 20,630.42 | 89.68 |
| 51829 Rrugët e rendit të IV - Doberlluke, Pestovë, Oshlan, Sllatin | 50,000.00 | 39,999.50 | 10,000.50 | 80.00 |
| 51830 Rregullimi i shtratit te lumit ,,Silnica" | 250,000.00 | 239,113.07 | 10,886.93 | 95.65 |
| 51831 Ndriçimi publik në Vushtrri, Doberrlukë, Maxhunaj, Stanoc | 25,000.00 | 18,279.80 | 6,720.20 | 73.12 |
| 51832 Kamerat ne qytet rr."D.Kombit" dhe shkollën SHMU-Vushtrri | 10,000.00 | 0.00 | 10,000.00 | 0.00 |
| 51833 Ndërtimi i urave dhe mureve mbrojtëse në Stanoc dhe Pantinë | 60,000.00 | 52,448.00 | 7,552.00 | 87.41 |
| 92060 NGRITJA E PERFORMANCES 2019 | 3,985.65 | 0.00 | 3,985.65 | 0.00 |
| 92111 PERFORMANCA KOMUNALE 2021 | 6,285.73 | 0.00 | 6,285.73 | 0.00 |
| 93195 NDERT.PIK.PRITESE PER AUTOB.PRI-ZHI-BIV-STR | 906.20 | 0.00 | 906.20 | 0.00 |
| **18428 ZJARRFIKËSIT INSPEKTIMET - VUSHTRRI** | **35,000.00** | **28,802.81** | **6,197.19** | **82.29** |
| 51834 Paisje (pompa uji) për zjarrfikësit e Komunës se Vushtrrisë | 30,000.00 | 23,808.06 | 6,191.94 | 79.36 |
| 52187 RENOVIMI I OBJEKTIT TË ZJARREFIKËSVE | 5,000.00 | 4,994.75 | 5.25 | 99.90 |
| **47024 BUJQËSIA - VUSHTRRI** | **513,439.67** | **107,190.42** | **406,249.25** | **20.88** |
| 48182 NGRITJA E PEMISHTEVE. | 991.00 | 0.00 | 991.00 | 0.00 |
| 49561 PROJEKTET NË BASHKËFINANCIM ME DONATORË | 430,761.44 | 64,254.14 | 366,507.30 | 14.92 |
| 51203 NDERTIMI I KANALEVE KULLUESE NE LUMMADH DHE DUMNICE E ULET | 5,439.65 | 5,438.58 | 1.07 | 99.98 |
| 51204 RR. I SHTR.TE LUME. NE STUDIME,MAXHUNAJ DHE DUMNICE E MESME | 8,085.00 | 8,085.00 | 0.00 | 100.00 |
| 51835 Regullimi i arginaturave të lumit "Silnica" | 66,360.58 | 27,612.70 | 38,747.88 | 41.61 |
| 72691 FURNIZIM ME MAKINA PËR SHKOKËLIMIN E MISRIT | 1,800.00 | 1,800.00 | 0.00 | 100.00 |
| 81152 NGRITJA E SERAVE | 2.00 | 0.00 | 2.00 | 0.00 |
| **66425 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKCIONI - VUSHTRRI** | **1,478,969.49** | **813,638.41** | **665,331.08** | **55.01** |
| 41424 NDERT.RRUG.LOKALE NE FSHATRA | 1,172,471.30 | 652,000.37 | 520,470.93 | 55.61 |
| 45265 ASFALTIMI I RRUGËVE NË QYTET | 43,525.58 | 43,525.58 | 0.00 | 100.00 |
| 49579 RREGULLIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE -SHESHEVE | 5,552.57 | 0.00 | 5,552.57 | 0.00 |
| 49588 MBJELLJA E DRUNJVE DEKORATIV | 13,044.33 | 11,664.95 | 1,379.38 | 89.43 |
| 51836 Riasfaltimi i rrugëve ne fshatrat Dunicë, Gllavotin, Pantinë | 30,000.00 | 24,636.50 | 5,363.50 | 82.12 |
| 51837 Ndërtimi i parqeve dhe mbjellja e drunjve dekorativ "Adem Jashari" | 75,000.00 | 30,000.01 | 44,999.99 | 40.00 |
| 52188 ASFALTIMI I RRUGES VESEKOC SLLAKOVC | 110,003.00 | 31,104.00 | 78,899.00 | 28.28 |
| 96018 SHËTITJE NË HISTORI | 29,372.71 | 20,707.00 | 8,665.71 | 70.50 |
| **74450 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR - VUSHTRRI** | **414,327.59** | **138,429.00** | **275,898.59** | **33.41** |
| 41427 NDERTIMI I QMF NE VUSHTRRI | 2,827.59 | 2,827.59 | 0.00 | 100.00 |
| 45253 PAISJE MJEKËSORE | 68,000.00 | 52,808.80 | 15,191.20 | 77.66 |
| 45261 FURNIZIM ME INVENTAR | 30,000.00 | 4,940.32 | 25,059.68 | 16.47 |
| 50059 AUTOMJET I TERENIT PËR SHËNDETËSI | 30,000.00 | 0.00 | 30,000.00 | 0.00 |
| 51838 Ndërtimi i aneksit në QKMF Vushtrri (depo dhe garazhe) | 40,000.00 | 37,799.81 | 2,200.19 | 94.50 |
| 51839 Renovimi dhe ngjyrosja e QMF-1, Vushtrri | 30,000.00 | 18,232.82 | 11,767.18 | 60.78 |
| 51840 Blerja dhe montimi i klimave në QKMF- Vushtrri | 5,000.00 | 4,290.00 | 710.00 | 85.80 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 51841 Paisje për lavanteri në QKMF-Vushtrri | 6,000.00 | 0.00 | 6,000.00 | 0.00 |
| 51842 Kamera për AMF-të në Maxhunaj,Pantinë,Druar dhe Smrekonicë | 8,000.00 | 0.00 | 8,000.00 | 0.00 |
| 51843 Rindërtimi i laboratorit në QMF-3 Vushtrri | 4,000.00 | 2,847.60 | 1,152.40 | 71.19 |
| 51844 Kaldaja elektrike QMF1 Vushtrri | 2,000.00 | 0.00 | 2,000.00 | 0.00 |
| 51845 Rregullimi i oborrit i QKMF-se Vushtrri | 31,000.00 | 0.00 | 31,000.00 | 0.00 |
| 51846 Ndërtimi i recepsionit në QKMF - Vushtrri | 4,500.00 | 4,500.00 | 0.00 | 100.00 |
| 52189 NDËRTIMI I DEPOSË PËR MBETURINA MEDICIONALE | 2,060.00 | 2,055.64 | 4.36 | 99.79 |
| 52190 NDËRTIMI I ZYRAVE ADMINISTRATIVE NË QKMF | 85,940.00 | 0.00 | 85,940.00 | 0.00 |
| 52192 RREGULLIMI I HAPSIRAVE TË RENTGENIT QKMF "DR SAFET IDRIZI" | 50,000.00 | 0.00 | 50,000.00 | 0.00 |
| 90263 TEKNOLOGJI INFORMATIVE | 15,000.00 | 8,126.42 | 6,873.58 | 54.18 |
| **75616 SHËRBIMET SOCIALE - VUSHTRRI** | **20,000.00** | **0.00** | **20,000.00** | **0.00** |
| 49628 RENOVIMI I QENDRËS PËR KUJDES DITOR PËR TE MOSHUAR | 20,000.00 | 0.00 | 20,000.00 | 0.00 |
| **75617 SHËRBIMET REZIDENCIALE - VUSHTRRI** | **8,800.00** | **8,800.00** | **0.00** | **100.00** |
| 50984 RENOVIMI I QENDRËS REZIDENCIALE | 8,800.00 | 8,800.00 | 0.00 | 100.00 |
| **85024 SHËRBIMET KULTURORE - VUSHTRRI** | **419,510.02** | **206,521.96** | **212,988.06** | **49.23** |
| 46840 RENOVIMI I STADIUMIT TË HENDBOLLIT "MUSA ABAZI" | 91,000.00 | 5,000.00 | 86,000.00 | 5.49 |
| 48361 NDËRTIMI I FUSHËS NDIHMËSE TE STADIUMI I FUTBOLLIT (FAZA II) | 10,510.00 | 10,059.16 | 450.84 | 95.71 |
| 49580 INVENTARIZIMI I QENDRËS SE KULTURËS | 66,000.00 | 18,200.00 | 47,800.00 | 27.58 |
| 51007 RENOVIMI I PALESTRËS ,,JETON TERRSTENA" | 120,000.00 | 85,000.00 | 35,000.00 | 70.83 |
| 51847 Ndërtimi i objektit ndihmës ne stadiumin ,,Ferki Aliu" | 60,000.00 | 31,699.40 | 28,300.60 | 52.83 |
| 51849 Blerja e aparaturës për kinema dhe funksionalizimi ne qendrë | 50,000.00 | 46,757.60 | 3,242.40 | 93.52 |
| 51850 Digjitalizimi i pultit dhe ndriçimit profesional për teatrin | 10,000.00 | 9,805.80 | 194.20 | 98.06 |
| 51851 Ndërtimi pllakave përkujtimore në Pasomë | 12,000.00 | 0.00 | 12,000.00 | 0.00 |
| **92120 ADMINISTRATA - VUSHTRRI** | **132,000.00** | **122,886.00** | **9,114.00** | **93.10** |
| 46575 TEKNOLOGJI INFORMATIVE | 132,000.00 | 122,886.00 | 9,114.00 | 93.10 |
| **93690 ARSIMI FILLOR - VUSHTRRI** | **658,249.00** | **343,685.77** | **314,563.23** | **52.21** |
| 41440 NDËRTIMI I RRETHOJAVE NË SHKOLLA | 2,878.14 | 0.00 | 2,878.14 | 0.00 |
| 46587 FUSHA SPORTIVE | 11,949.40 | 10,271.40 | 1,678.00 | 85.96 |
| 47909 NDËRTIMI I ÇERDHËS SË RE | 39,557.60 | 39,557.60 | 0.00 | 100.00 |
| 47970 SALLA SPORTIVE | 22,280.00 | 22,280.00 | 0.00 | 100.00 |
| 51008 NDËRTIMI I TOLETEVE NË SHKOLLA | 2,229.00 | 2,228.56 | 0.44 | 99.98 |
| 51852 Inventar për shkolla SHMU ,,Anton Zako Çajupi | 22,000.00 | 0.00 | 22,000.00 | 0.00 |
| 51853 Fusha sportive dhe rrethoja në SHMU Lummadh | 29,000.00 | 18,318.00 | 10,682.00 | 63.17 |
| 51854 Ndërtimi i tualeteve ne SHMU ,,Emin Duraku" | 44,319.56 | 0.00 | 44,319.56 | 0.00 |
| 51855 Ndërtimi i platove me kubëza betoni në SHMU Vushtrri | 30,000.00 | 23,835.07 | 6,164.93 | 79.45 |
| 51857 Fusha sportive në SHMU ,,Enver Hadri" | 7,000.00 | 0.00 | 7,000.00 | 0.00 |
| 51858 Depo për SHF ,,Naim Frashëri"- Vushtrri | 11,796.36 | 10,954.10 | 842.26 | 92.86 |
| 51859 Depo për SHF ,,Latif Berisha" | 4,600.00 | 3,917.20 | 682.80 | 85.16 |
| 51860 Depo për SHF ,,Mustafë Shyti" Oshlan | 4,600.00 | 3,432.00 | 1,168.00 | 74.61 |
| 51861 Inventari për SHMU "Lumni Surdulli" Samadrexhë | 10,000.00 | 0.00 | 10,000.00 | 0.00 |
| 51862 Ndërtimi i rrethojave në SHMU "Mustafë Shyti" Oshlan | 3,500.00 | 0.00 | 3,500.00 | 0.00 |
| 51863 Ndërtimi i rrethojave ne SHFU "Rilindja" Vilanc | 3,000.00 | 0.00 | 3,000.00 | 0.00 |
| 51864 Meremetimi i SHMU "Adem Voca" Pasomë | 65,000.00 | 46,473.60 | 18,526.40 | 71.50 |
| 51865 Meremetimi i SHMU "Lumni Surdulli" | 31,000.00 | 23,571.80 | 7,428.20 | 76.04 |
| 51866 Meremetimi i SHMU,,Enver Hadari" - Smrekonicë | 30,000.00 | 29,315.81 | 684.19 | 97.72 |
| 51867 Meremetimi i SHMU "Rilindja" Vilanc | 8,000.00 | 6,250.40 | 1,749.60 | 78.13 |
| 51868 Meremetimi i shf. "Ali Kelmendi" - Studime | 45,000.00 | 26,951.20 | 18,048.80 | 59.89 |
| 51869 Meremetimi i SHFMU "Mihaliq" | 2,000.00 | 1,506.80 | 493.20 | 75.34 |
| 51870 Meremetimi i SHFMU "Rexhep Musa" | 5,000.00 | 2,638.00 | 2,362.00 | 52.76 |
| 51871 Rregullimi i SHFMU-së në Stanofc me infrastrukturë | 35,000.00 | 26,467.00 | 8,533.00 | 75.62 |
| 51872 Meremetimi i SHF Naim Frashëri dhe ndërtimi i tualeteve | 26,000.00 | 24,214.22 | 1,785.78 | 93.13 |
| 51873 Meremetimi i SHFMU "Azem Bejta" - Beçiq | 20,000.00 | 15,961.07 | 4,038.93 | 79.81 |
| 52191 NDËRTIMI I SHKOLLËS NË GLLAVOTIN | 136,997.00 | 0.00 | 136,997.00 | 0.00 |
| 90282 MEREMETIMI I SHKOLLAVE | 5,541.94 | 5,541.94 | 0.00 | 100.00 |
| **94890 ARSIMI I MESËM - VUSHTRRI** | **105,734.05** | **0.00** | **105,734.05** | **0.00** |
| 51874 Paisje për praktike profesionale SHMP "Bahri Haxha" | 55,000.00 | 0.00 | 55,000.00 | 0.00 |
| 51875 Kaldaja për ngrohje qendrore "Lutfi Musiqi"SHMU II | 20,000.00 | 0.00 | 20,000.00 | 0.00 |
| 51876 Paisje laboratorike SHMP "Bahri Haxha" | 10,000.00 | 0.00 | 10,000.00 | 0.00 |
| 51877 Renovimi i ngrohjes qendrore SHMP "Bahri Haxha" | 20,000.00 | 0.00 | 20,000.00 | 0.00 |
| 93222 RREGULLIMI I SHKOLLES BAHRI HAXHA | 577.05 | 0.00 | 577.05 | 0.00 |
| 95104 FURNIZ.MJETE PER PUNTOR.SALDATOR-AXHUSTATOREVE | 157.00 | 0.00 | 157.00 | 0.00 |
| **Totali I Përgjithshëm** | **6,042,316.42** | **3,356,006.92** | **2,686,309.50** | **55.54** |

Sqarim:

Duke u bazuar në planifikimin e buxhetit të vitit 2022 në kategorin e investimeve kapitale konkludojm se:

Buxheti I planifikuar I investimeve kapitale nga Grandi Qeveritar fondi (10),është 3,764,964.00euro.

I realizuar është 2,640,747.60euro,shprehur në perqindje realizimi është 74.14%

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br. 41/23
Nr. i Sq. / Br. st
Data: / Datum 16.01.2023
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Sheshi "Ahmet Krasniqi" nr. 10, Tel.038/200 42402, E-mail: ferit.idrizi@rks-gov.net

| | |
|---|---|
| PËR/ZA/TO: | Kuvendin e Komunës |
| CC | |
| PROPOZUES | Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës |
| NGA/OD/FROM: | **Komisioni:**<br>Xhavit Mehmeti, Kryesues ______<br>Bujar Pllana anëtar ______<br>Haki Maloku, anëtar ______ |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Akt përcjellës i Draft Rregullores |

---

Të nderuar/a anëtar/e të Kuvendit,

Kryetari i Komunës ka themeluar komisionin për Draftim të Rregullores KKV Nr. 06/2020 datë 30.07.2020 për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Veprimtarive Afariste – Bizneseve në Komunën e Vushtrrisë në përbërje: Xhavit Mehmeti, kryesues, Bujar Pllana, anëtar dhe Haki Maloku, anëtar.

Komisioni ka përgatitur Draft Rregulloren në fjalë dhe ka zbatuar procedurat e konsultimit publik.

Draft Rregullorja ju dërgohet për shqyrtim dhe miratim.

Me respekt,

Në bazë të nenit 1 2, paragrafi 12.2, shkronja (c) të Ligjit Nr,03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 40 të Ligjit Nr.2004/ 18 për Tregtinë e Brendshme, dispozitave të nenit 19, paragrafi 1, pika 1.3 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më ________ 2022 miratoi këtë:

# DRAFT RREGULLORE
# PËR FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS TË VEPRIMTARIVE AFARISTE - BIZNESEVE NË KOMUNËN E VUSHTRRISË

## Neni 1
## Qëllimi

1. Me këtë rregullore themelohet baza juridike për rregullimin e orarit të punës për veprimtaritë afariste biznesore në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

## Neni 2
## Fushëveprimi

Veprimtaritë afariste - bizneset në pajtim me nenin 1 të kësaj rregulloreje, janë të obliguara t'i përmbahen orarit të punës, të përcaktuar me këtë rregullore.

## Neni 3
## Orari i punës

1. Orari i punës nënkupton periudhën kohore të fillimit dhe mbarimit të punës.
2. Orari për fillimin dhe mbarimin e punës, i përcaktuar me këtë rregullore, duhet të vendoset në hyrje apo në vend të dukshëm të objektit në të cilin kryhet veprimtaria afariste – biznesi dhe duhet saktësuar fillimi dhe mbarimi i orarit të punës, dhe ditët që nuk punohet.

3. Orari i punës përcaktohet në bazë të dy periudhave, në atë verore dhe dimërore, në këto intervale kohore:
3.1 Periudha verore fillon më 1 prill dhe zgjat deri më 31 tetor të vitit kalendarik;
3.2 Periudha dimërore fillon më 1 nëntor dhe zgjat deri me 31 mars të vitit kalendarik.

## Neni 4
## Orari i punës për dyqane zejtare dhe veprimtari të ngjashme

4.1. Furrat e bukës dhe pastiqeritë:
4.1.1 Periudha verore prej orës 06:00 – 23:00;
4.1.2 Periudha dimërore prej orës 07:00 – 22:00.
4.1.3 Ditëve të diela do të punojnë deri në ora 12:00.

4.2 Furrat e bukës gjatë muajit të Ramazanit mund të punojnë pa ndërprerë 24 orë.

4.3. Autoserviset, autolarjet dhe vullkanizerët:

4.3.1 Periudha verore prej orës 08:00 – 19:00;
4.3.2 Periudha dimërore prej orës 09:00 – 18:00.

4.4. Rrobaqepësit, këpucëtarët, serviserët dhe orëtarët:
4.4.1 Periudha verore prej orës 08:00 – 20:00;
4.4.2 Periudha dimërore prej orës 08:00 – 18:00.

4.5 Sallonet e ondulimit:
4.5.1 Periudha verore prej orës 06:00 – 20:00;
4.5.2. Periudha dimërore prej orës 08:00 – 19:00

4.6. Frizerët:
4.6.1 Periudha verore prej orës 08:00 – 20:00;
4.6.2 Periudha dimërore prej orës 08:00 – 19:00

4.7. Salduesit, teneqepunuesit, farkëtarët dhe dyqanet tjera zejtare:
4.7.1 Periudha verore prej orës 08:00 – 19:00;
4.7.2 Periudha dimërore prej orës 08:00 – 18:00.

4.8. Ditën e vikendit (e diel) dhe ditët e festave zyrtare, dyqanet zejtare nuk do të punojnë, në përjashtim të veprimtarive zejtare neni 4, paragrafi 4.5. që do të caktojnë një ditë pushimi brenda javës - ditëve të diela ose të martave.

**Neni 5**
**Orari i punës i qendrave tregtare, marketeve, dyqaneve tregtare ushqimore, pijeve, duhanit si dhe tregtia e çdo veprimtarie tjetër të artikujve joushqimor**

5.1. Qendrat tregtare, marketet, dyqanet tregtare ushqimore, të pijeve dhe duhanit:
5.1.1 Në periudhën verore prej orës 07:00 – 22:00;
5.1.2 Në periudhën dimërore prej orës 08:00 – 21:00.

5.2. Tregtia e veprimtarive të artikujve joushqimor:
5.2.1 Periudha verore prej orës 08:00 - 22:00;
5.2.2 Periudha dimërore prej orës 08:00 - 21:00.

5.3. Autosallonet dhe autopjesët e automjeteve të përdorura:
5.3.1 Periudha verore prej orës 08:00 - 20:00;
5.3.2 Periudha dimërore prej orës 08:00 - 18:00.

5.4. Ditën e vikendit (e diel) dhe festave zyrtare bizneset nga neni 5, nuk punojnë.

**Neni 6**
**Orari i punës i depove**

6.1. Depot e të gjitha llojeve të veprimtarive afariste:
6.1.1 Periudha verore prej orës 08:00 - 18:00;

6.1.2 Periudha dimërore prej orës 08:00 - 17:00.

6.2. Ditën e vikendit (e diel) dhe ditëve të festave zyrtare, bizneset nga neni 6, nuk punojnë.

**Neni 7**
**Akomodimi, shërbimet ushqimore dhe të pijeve**

7.1 Restaurantet, veprimtaritë shërbyese të pijeve, qebaptoret, gjellëtoret, fast food, veprimtaritë lëvizëse të ushqimit dhe veprimtaritë e ngjashme:
7.1.1 Në periudhën verore prej orës 07:00 - 00:00;
7.1.2 Në periudhën dimërore prej orës 07:00 - 23:00.

7.2. Akomodimi në hotele dhe motele është i njëjtë në të dy sezonat 24 orë - (non stop).

7.3. Diskotekat dhe klubet e natës:
7.3.1 Në periudhën verore prej orës 22:00 - 04:00;
7.3.2 Në periudhën dimërore prej orës 21:00 - 03:00.

7.4 Veprimtaritë afariste — bizneset që organizojnë muzikë live, evente të ndryshme dhe ahengje familjare, mund të punojnë më gjatë se orari i punës, por jo më shumë se ora 03:00 e mëngjesit.

7.5. Veprimtaritë afariste nga paragrafi 7.4 i këtij neni duhet kërkojnë leje të veçantë (24 orë më herët) për orare më të gjatë të punës (deri në ora 03.00 e mëngjesit) të cilën e lëshon Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillini Rural. Ppër vazhdimin e orarit të punës duhet paguar taksë shtesë tridhjetë (30.00) € për orë.

**Neni 8**

**Orari i punës për aktivitete sportive dhe rekreative, lojërat zbavitëse, internet-kafetë**

8.1 Stadiumet, palestrat sportive dhe objektet tjera rekreative, për të dy sezonat 08:00 - 00:00.

8.2. Lojërat zbavitëse dhe internet-kafetë:
8.2.1 Në periudhën verore prej orës 07:00 - 00:00;
8.2.2 Në periudhën dimërore prej orës 08:00 - 23:00.

8.3 Qendra trajnimi për aftësim praktik dhe teorik me armë për të dy sezonat 08:00 - 00:00.

**Neni 9**
**Orari i punës për qendrat e thirrjeve "Call Center"**

Bizneset që ushtrojnë veprimtari "Call Center" dhe veprimtari të ngjashme, orari i punës do të përshtatet me orarin e punës sipas orës së shteteve, të cilat kanë tjetër matje kohore.

**Neni 10**
**Orari i punës për tregje**

10.1 Tregjet e qytetit dhe tregjet e lokaliteteve:
10.1.1 Në periudhën verore prej orës 07:00 — 19:00;
10.1.2 Në periudhën dimërore prej orës 08:00 — 18:00.

10.2. Ditën e vikendit ( e diel) dhe ditëve të festave zyrtare, bizneset nga nenin 10, paragrafi 10.1, nuk punojnë.

10.3. Tregu i kafshëve punon vetëm ditën e premte, prej orës 07:00 - 15:00.

**Neni 11**
**Orari i punës për pikat e shitjes së karburanteve**

11.1. Pikat e shitjes së karburanteve punojnë për të dy sezonat 24 orë – non stop.

11.2 Restorantet dhe marketet e vogla deri 50 m2, si dhe veprimtaritë tjera afariste të cilat janë të ngjitura me pika të shitjes të karburanteve, përjashtimisht autolarjeve mund të punojnë për të dy sezonat 24 orë – NON – STOP.

**Neni 12**
**Orari i punës për barnatore, ordinanca dhe klinika private**

12.1. Barnatoret, ordinancat dhe klinikat private, punojnë për të dy sezonat prej orës 07:00 - 22:00, me përjashtim të ditëve te diela.

12.2. Barnatoret do të punojnë në harmoni me planin për kujdestari, të hartuar në bashkëpunim me Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;
12.2.1. Barnatoret kujdestare punojnë gjatë ditëve të punës 22:00 deri në ora 07:00;
12.2.2 Barnatoret kujdestare gjatë ditëve të diela punojnë prej orës 07 :00 - 22:00;
12.2.3 Barnatoret kujdestare gjatë ditëve të diela pas orës 22:00 punojnë sipas orarit të përcaktuar në paragrafin 12.2.2.

**Neni 13**
**Orari i punës për ndërtimtari përfshirë renovimet e jashtme, të brendshme dhe infrastrukturën tokësore dhe nëntokësore**

13.1 Ndërtimtaria përfshirë renovimet e jashtme dhe të brendshme dhe infrastrukturën tokësore dhe nëntokësore:
13.1.1 Në periudhën verore prej orës 08:00 – 18 :00;
13.1.2 Në periudhën dimërore prej orës 08:00 – 17:00.

13.2 Ditën e vikendit (e diel) dhe ditëve të festave zyrtare, veprimtaritë nga neni 13, nuk punojnë.

## Neni 14
## Orari i punës për barnatoret bujqësore, dyqanet me produkte bujqësore dhe ordinancat veterinare

14.1 Barnatoret bujqësore, dyqanet me produkte bujqësore dhe ordinancat veterinare:
14.1.1 Në periudhën verore prej orës 08:00 – 19 :00;
14.1.2 Në periudhën dimërore prej orës 08:00 – 18:00.

14.2 Ditën e vikendit (e diel) dhe ditëve të festave zyrtare, veprimtaritë nga neni 14, nuk punojnë.

## Neni 15
## Orari e punës për miniera dhe gurore

15.1 Minierat dhe guroret:
15.1.1 Në periudhën verore prej orës 08:00 – 18 :00;
15.1.2 Në periudhën dimërore prej orës 08:00 – 16:00.

15.2 Ditën e vikendit (e diel) dhe ditëve të festave zyrtare, veprimtaritë nga neni 15, nuk punojnë.

## Neni 16
## Orari i punës i veprimtarive financiare dhe të sigurimit

16.1 Veprimtaritë financiare dhe të sigurimit:
16.1.1 Në periudhën verore prej orës 08:00 – 17 :00;
16.1.2 Në periudhën dimërore prej orës 08:00 – 16:00.

16.2 Ditët e vikendit (e shtunë dhe e diel) dhe ditëve të festave zyrtare, veprimtaritë nga neni 16, nuk punojnë.

## Neni 17
## Orari i punës i veprimtarive të patundshmërisë

17.1 Veprimtaritë e patundshmërisë:
17.1.1 Në periudhën verore prej orës 08:00 – 18 :00;
17.1.2 Në periudhën dimërore prej orës 08:00 – 17:00.

17.2 Ditën e vikendit (e diel) dhe ditëve të festave zyrtare, veprimtaritë nga neni 17, nuk punojnë.

## Neni 18
## Orari i punës i veprimtarive profesionale, shkencore dhe teknike

18.1 Veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike:

18.1.1 Në periudhën verore prej orës 08:00 – 18 :00;
18.1.2 Në periudhën dimërore prej orës 08:00 – 17:00.

18.2 Ditën e vikendit (e diel) dhe ditëve të festave zyrtare, veprimtaritë nga neni 18, nuk punojnë.

**Neni 19**
**Orari i punës për shërbimet administrative dhe mbështetëse**

19.1 Shërbime administrative dhe mbështetëse:
19.1.1 Në periudhën verore prej orës 08:00 – 00 :00;
19.1.2 Në periudhën dimërore prej orës 08:00 – 23:00.

**Neni 20**
**Orari i punës i veprimtarive arsimore dhe edukimit joformal**

20.1. Veprimtaritë arsimore dhe edukimit joformal:
20.1.1 Në periudhën verore prej orës 07:00 – 21:00;
20.1.2 Në periudhën dimërorë prej orës 07:00 – 20:00.

20.2 Ditën e vikendit (e diel) dhe ditëve të festave zyrtare, veprimtaritë nga neni 19, nuk punojnë.

**Neni 21**

**Orari i punës për biznese përpunuese dhe prodhuese**

**21.1 Bizneset përpunuese dhe prodhuese**
**21.1.1** Në periudhën verore prej orës 08:00-20:00
21.1.2 Në periudhën dimërore prej orës 08:00-19:00
21.2 Bizneset përpunuese dhe prodhuese mund të punojnë 24 orë pa ndërpre nëse në ato biznese nuk mund të ndalet procesi i përpunimit dhe prodhimit.
21.3 Bizneset nga paragrafi 21.1 ditën e diel nuk do të punojnë përveç bizneseve nga paragrafi 21.2.

**Neni 22**
**Pezullimi i përkohshëm i dispozitave të kësaj rregulloreje**

Në rrethana të caktuara sipas vlerësimit të Kryetarit të komunës dhe rekomandimit nga faktorë tjerë institucionalë dhe qytetar, Kryetari i komunës mund të pezullojë përkohësisht zbatimin e dispozitave të caktuara të kësaj rregulloreje dhe përcaktoj me vendim orarin e përkohshëm brenda vitit kalendarik për veprimtari të caktuara biznesore.

## Neni 23
## Dispozitat ndëshkuese

Të gjitha veprimtaritë afariste - bizneset do të gjobiten nga 300.00 -1,000.00 €, në qoftë se veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.

## Neni 24
## Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

24.1 Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdeset: Drejtoria për Inspektime - inspektorati i tregut, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, policia e Kosovës.

24.2 Të gjitha veprimtaritë afariste - bizneset janë të obliguara që të harmonizojnë orarin e punës me dispozitat e kësaj rregulloreje, në afatin prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

24.3 Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja KKV-Nr. 06/2020 datë 30.7.2020 për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës të Veprimtarive Afariste - Bizneseve në Komunën e Vushtrrisë.

## Neni 25
## Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.